



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT

Nr. regjistri 3/2019 (JR)
Datë 11.01.2019

Vendim nr. 34 (JR)
Datë 02.12.2019

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Natasha Mulaj	Kryesuese
Ardian Hajdari	Relator
Luan Daci	Anëtar
Ina Rama	Anëtare
Rezarta Schuetz	Anëtare

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore të zhvilluar në dhomë këshillimi, më datë 02.12.2019, ora 09:30, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Ferdinando Buatier de Mongeot, me Sekretare Gjyqësore Adelajda Hiska, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit nr. 3/2019 (JR), datë 11.01.2019, që i përket:

ANKUESE: Subjekti i rivlerësimit, znj. Entela Prifti, me detyrë gjyqtare/kryetare, pranë Gjykatës së Apelit, Korçë.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, nr. 69, datë 10.10.2018, që i përket subjektit të rivlerësimit Entela Prifti.

BAZA LIGJORE E ANKIMIT: Neni 63 dhe vijues i ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm i Apelit,

pasi e shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), dëgjoi gjyqtarin relator të çështjes Ardian Hajdari, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Vendimi i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, me vendimin objekt shqyrtimi që mban numrin 69, datë 10.10.2018, ka vendosur:

Shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Entela Prifti, me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Apelit Korçë.

Komisioni ka arritur në vendimmarrjen e mësipërme, bazuar në nenin 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, duke arritur në konkluzionet e mëposhtme.

Për vlerësimin tërësor në lidhje me kriterin e pasurisë, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit:

i. nuk arriti të provojë bindshëm fshehjet e deklarimeve të depozitave, llogarive bankare dhe likuiditeteve të ndryshme në deklarata periodike vjetore të interesave privatë pranë ILDKPKI-së;

ii. nuk arriti të justifikojë me dokumentacion ligjor provues shumë nga pasuritë e mosdeklaruarua ndër vite;

iii. nuk arriti të provojë ligjshmërinë e të ardhurave të personave të tjerë të lidhur (motrës, babait dhe bashkëshortit të motrës), për blerjen e pasurive të denoncuar nga publiku dhe të konstatuara nga hetimi i Komisionit;

iv. nuk arriti një nivel të besueshëm në lidhje me vlerësimin e pasurisë;

v. me anë të veprimeve dhe mosveprimeve të saj në lidhje me vlerësimin e pasurisë, subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë dhe ndodhet në kushtet e pamundësisë për plotësimin e mangësive nëpërmjet programit të trajnimit.

2. Kundër vendimit nr. 69, datë 10.10.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), brenda afatit ligjor, rezulton të jetë ushtruar ankim nga subjekti i rivlerësimit, znj. Entela Prifti (në vijim “subjekti i rivlerësimit”). Ky ankim ka rezultuar i plotë edhe në elementet e tjera, si të formës, edhe të përmbajtjes. Për rrjedhojë, me vendimin nr. 69/1, datë 27.12.2018, Komisioni ka vendosur pranimin e ankimit të datës 27.12.2018, me nr. {***} prot., të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit, në përputhje me nenin 46 të ligjit nr. 49/2012 “Për gjykatat administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative” (në vijim “ligji nr. 49/2012”).

II. Shkaqet e ankimit

Subjekti i rivlerësimit, në ankimin e tij ndaj vendimit nr. 69, datë 10.10.2018, të Komisionit, ka paraqitur shkaqet si më poshtë.

3. Në lidhje me shkaqet e ankimit për procesin e rregullt ligjor, subjekti i rivlerësimit pretendon në ankim se vendimi objekt shqyrtimi është marrë:
 - në shkelje të të drejtave personale e ligjore të parashikuara nga KEDNj-ja¹;
 - në shkelje të ligjit procedural;
 - në interpretim të gabuar, dashakeqës, subjektiv të provave dhe rrethanave;
 - në mungesë të një analize të provave e fakteve;
 - në kushte të një procesi të parregullt, duke u paragjykuar dhe duke u cenuar nga sjellja e komisionerëve;
 - në shkelje të parimeve të objektivitetit dhe proporcionalitetit;
 - në cenim të figurës dhe personalitetit të subjektit dhe cenimit të të drejtave të personave të tretë.
4. Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni e ka bazuar tërësisht gabim vendimin në pikën 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, e cila i referohet pikës 2 të nenit 4 të po këtij ligji, pasi Komisioni nuk provoi pse subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te drejtësia, pasi ky cenim lidhet me dy kriteret e tjera të rivlerësimit, konkretisht figura dhe profesionalizmi, të cilat në rastin konkret janë tërësisht të pashqyrtuara.
5. Subjekti i rivlerësimit pretendon në ankim se vendimi objekt shqyrtimi ka karakterin e një dënimi penal dhe me fuqi prapavepruese, si dhe shkalla e ashpërsisë së këtij vendimi ndalon në mënyrë permanente edhe fitimin e titullit “avokat”.
6. Subjekti i rivlerësimit pretendon në ankim se deklarata *vetting*, e shoqëruar me barrën e provës, është në shkelje të nenit 6/1 të KEDNj-së. Në këtë këndvështrim, subjekti i rivlerësimit, nëpërmjet ankimit, duke iu referuar Protokollit 16 të KEDNj-së, kërkoi që Kolegji t’i drejtohet Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut (në vijim “GjEDNj”) për marrjen e opinionëve të mëposhtme.
 - a) Procesi kalimtar i vlerësimit të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, në rast se kryhet vetëm për një kriter, atë të vlerësimit të pasurisë, a përbën shkelje të nenit 6 të KEDNj-së dhe, në përgjithësi, të standardeve të pavarësisë së gjyqësorit?
 - b) Kryerja e procedurave hetimore mbi bazën e deklaratës *vetting* të gjyqtarëve dhe kalimi të këta të fundit i barrës së provës, a është në përputhje me jurisprudencën e nenit 6/1 të KEDNj-së dhe të parimit të mosinkriminimit (selfincrimination)?
 - c) Masat e marra nga organet respektive të ngritura në procesin e vlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, a mund të konsiderohen për konceptin “autonomy” të Konventës si “sanksion me natyrë penale”, për të cilin ndalohet zbatimi për to me efekt prapaveprues?

¹ Konventa Evropiane e të Drejtave të Njeriut.

7. Subjekti i rivlerësimit, znj. Entela Prifti, në ankimin e saj, kërkoi shqyrtimin e çështjes në seancë publike me praninë e palëve për të mundësuar dëgjimin dhe krijimin e një bindjeje më të plotë se në Komision.
8. **Lidhur me pasurinë “apartament banimi, me sipërfaqe 55 m², me adresë rr. “{***}”, Korçë**”, subjekti i rivlerësimit pretendon se nuk ka kryer fshehje të pasurisë siç ka pranuar Komisioni, me arsyetimin se bashkëshorti i saj, si person i lidhur, nuk ka deklaruar pasurinë e përbashkët, e cila është deklaruar nga njëri bashkëshort, ndaj si person i lidhur ka pasur detyrimin të deklarojë vetëm pasuritë e regjistruara veçmas nga subjekti i rivlerësimit. Sipas këtij të fundit, deklarimi i mësipërm duhet të konsiderohet i saktë dhe i plotë.
9. Subjekti i rivlerësimit pretendon se vendimi i Komisionit në lidhje me konstatimet e mungesës së burimeve financiare dhe deklarimit të rremë për këtë pasuri janë të gabuara dhe në kundërshtim me provat e paraqitura. Për krijimin e kësaj pasurie, kanë shërbyer të ardhurat familjare nga kursimet dhe një pagesë prej 1.600.000 lekësh, e kryer *cash* nga ana e babait të bashkëshortit të subjektit. Gjithashtu pretendon se nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur në Komision ka provuar mundësinë e pagimit nga babai i bashkëshortit të shumës së mësipërme.
10. Subjekti i rivlerësimit ka pretenduar në ankim se Komisioni nuk ka pranuar se një pjesë e kursimeve të krijuara nga prindërit e bashkëshortit ka ardhur edhe nga shitja e shtëpisë së vajzës së tyre, në shumën 1.800.000 lekë, fakt që nuk u konsiderua nga Komisioni vetëm për arsyen se nuk kishte një provë shkresore për këtë dhurim, duke qenë se kontrata e dhurimit mund të bëhet edhe me gojë, sipas Kodit Civil, neni 761 e vijues. Detyrim është të lidhet kontratë noteriale vetëm në rastin e kalimit të pasurisë së paluajtshme.
11. Subjekti i rivlerësimit pretendon se pagesa nga ana e bashkëshortit në {***} ShBA nuk ka lidhje me shumën e shitjes së banesës së motrës së bashkëshortit. Për të gjitha këto arsye, subjekti mendon se deklarimi për burimin e kësaj pasurie duhet të vlerësohet i rregullt, pasi bazohet në faktin se prona është krijuar me burime të ligjshme të ardhurash. Komisioni qëllimisht për të dëmtuar interesat e subjektit ka bashkuar dy situata financiare në një, konkretisht transfertën bankare të kryer nga bashkëshorti i subjektit, nga llogaria e tij në NBG Bank Korçë, drejt llogarisë bankare të P.B. në {***} Miçigan, e konsideruar si një debi e vitit 2002, për të cilën Komisioni ka vlerësuar se lidhet me shumën e shitjes së banesës së motrës së bashkëshortit.
12. **Lidhur me pasurinë “apartament banimi, me sipërfaqe 70 m², e ndodhur në rr. “{***}”, Korçë**”, sipas subjektit, vendimi i Komisionit është në kundërshtim me provat e administruara. Në ankim subjekti i rivlerësimit shpjegon se objekt i verifikimit në Komision është deklarata *vetting* dhe, për këtë arsye, vlerësimi për deklarim të rremë është tërësisht i pabazuar. Subjekti e ka shpjeguar se diferenca prej 1.150.000 lekësh midis deklarimit të vlerës së shitjes në vitin 2005 (3.100.000 lekë) dhe kontratës së shitjes (me vlerë 1.950.000 lekë) vjen si pasojë e shtimit të vlerës së përfituar nga shitja e sendeve të luajtshme të banesës dhe nga mungesa e rregullimit ligjor për udhëzimin e plotësimit të deklaratës së pasurisë. Gjithashtu subjekti i rivlerësimit pretendon se përfitimi i vlerës nga shitja e këtij apartamenti nga ana e subjektit, është deklaruar në deklaratën e interesave privatë periodikë (në vijim

“DIPP”) të vitit 2005 dhe në deklaratën *vetting*, saktësisht 1.000.000 lekë, e cila është e mjaftueshme për të mbuluar vlerën e marrë hua nga prindërit para shitjes së kësaj pasurie. Për më tepër, nga Komisioni, po ashtu edhe nga Inspektorati i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”) nuk është marrë parasysh një akt i përpiluar me shkrim dore ndërmjet subjektit dhe prindërve të saj, sipas të cilit subjekti nuk do të përfitonte shumë tjetër, sado që të ishte vlera e shitjes, përveç shumës së dhënë hua.

13. **Lidhur me të ardhurat e krijuara nga shitja e automjeteve**, subjekti i rivlerësimit pretendon se me shqyrtimin në Komision të të ardhurave nga shitja e automjeteve të subjektit, ky i fundit pretendon se makinat janë blerë në gjendje jashtë kushteve teknike dhe, për shkak të investimeve në aksesore, në momentin e shitjes kanë qenë në gjendje më të mirë se në momentin e blerjes. Çmimi i shitjes nuk ka qenë më i lartë se çmimi i tregut. Subjekti i rivlerësimit pretendon se për këtë pasuri nuk ka kryer deklaram të rremë dhe nuk ka fshehur vlerën reale të shitjes së automjeteve, duke mos shkelur në këtë mënyrë asnjë ligj, siç pretendohet nga Komisioni.
14. **Lidhur me pasurinë “apartament banimi dupleks, me sipërfaqe 235 m², ndodhur në rr. “{***}”, Korçë**, subjekti i rivlerësimit pretendon se përfundimi i Komisionit se subjekti ka bërë deklaram të rremë në lidhje me investimin personal për përfundimin e rifiniturave në vlerën 1.316.300 lekë, nuk është i bazuar në dokumente provuese. Subjekti i rivlerësimit ka sjellë preventivin e punimeve të cilin e ka pranuar edhe firma e ndërtimit, por që nuk mund ta gjejë në arkivat e saj preventivin dhe kontratën për shkak të kohës së largët prej 17 vitesh, si dhe për shkak të vjedhjes së arkivave të firmës disa herë.
15. Subjekti i rivlerësimit pretendon se pasuria e blerë ishte në gjendjen e karabinasë dhe e ka pasur të nevojshme përshtatjen për banim duke kryer punime sipas situacionit. Gjithashtu pretendon se konkluzioni në vendim i Komisionit është në kundërshtim me ligjin, kur theksohet se ka fshehur çmimin real të pasurisë së blerë, duke iu referuar kostove mesatare të ndërtimit, të përcaktuara nga Enti Kombëtar i Banesave (në vijim “EKB”), të cilat janë referuese dhe të destinuara për ndërtime të kryera nga firma ndërtimi për objekte sociale, ndaj nuk mund të merren *apriori*.
16. Subjekti i rivlerësimit pretendon se vendimi i Komisionit për pamjaftueshmëri të burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie, është tërësisht i kundërligjshëm, pasi nuk merr parasysh prova dhe përlllogarit në mënyrë të gabuar të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit për vitet kur është krijuar kjo pasuri. Subjekti pretendon se Komisioni ka bërë gabim duke mos përlllogaritur të ardhurat e subjektit dhe të bashkëshortit të saj që nga viti 1985 deri në vitin 2000, edhe pse subjekti i ka sjellë dhe aktet provuese.
17. Subjekti i rivlerësimit pretendon se shuma 2.893.050 lekë nuk ka qenë e ardhur gjendje në bankë e subjektit të rivlerësimit, por ka qenë shumë e hedhur gabim në llogarinë personale të bashkëshortit të subjektit, në vend që të hidhej në llogarinë e Ujësjiellës Kanalizime Korçë (në vijim “UKKO”) dhe më pas është sistemuar nga banka. Në përfundim të këtij shkak ankimi, subjekti përmbledh se në analizë të të ardhurave të realizuara nga momenti i fillimit të

marrëdhënieve të punës për subjektin dhe bashkëshortin e saj, deri në vitin 2004 justifikohen plotësisht investimet e kryera dhe shpenzimet familjare.

18. **Lidhur me pasurinë “banesë, me sipërfaqe 198 m², “{***}”, ndodhur në {***}, Korçë”,** subjekti i rivlerësimit pretendon se deklarimi për këtë pasuri është bërë sipas dokumentacionit të ZRPP-së në lidhje me sipërfaqen e banesës. Në analizë të rrethanave, thuhet në ankim, rezulton se deklarimi për këtë pasuri duhet të konsiderohet i saktë, në përputhje me ligjin dhe aktet nënligjore në fuqi, konkretisht udhëzimin e ILDKPKI-së për mënyrën e plotësimit të deklaratës *vetting*.
19. Në lidhje me përfitimin e pronësisë së banesës për fitimin e ½ pjesë takuese me kontratë dhurimi, subjekti i rivlerësimit pretendon se përfundimet e Komisionit janë tërësisht në kundërshtim me ligjin nr. 84/2016, legjislacionin material e procedural që rregullon marrëdhëniet e kontratës së qirasë dhe vlerën e provave shkresore e, në këto rrethana, edhe për këtë pjesë, vendimi duhet të ndryshohet. Lidhur me vlerësimin e deklaratës së dorës si e pavlefshme të administratores së pronës, Komisioni ka mbajtur qëndrime subjektive. Referuar dispozitave, si nenet 246 dhe 258 të Kodit të Procedurës Civile, Komisioni nuk ka mundur të provojë asnjë element të pavlefshmërisë së saj.
20. Subjekti i rivlerësimit pretendon se, sa i përket konkluzionit të Komisionit se subjekti nuk ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të blerjes të ½ pjesë të godinës në shumën 4.000.000 lekë, të gjitha burimet e përdorura për këtë blerje janë të ligjshme. Subjekti sqaron se ka dhënë shpjegimet e nevojshme për secilën nga këto burime, të ardhura nga kursimet nga pagat, shitja e makinës 6000 euro, si dhe bonot e thesarit të prindërve të bashkëshortit deri në vitin 2008.
21. Gjithashtu subjekti i rivlerësimit nëpërmjet ankimit kundërshton faktin se Komisioni krahason një ndërtim tejet të amortizuar të viteve 1930 me një pronë të ndryshuar dhe të investuar nga subjekti në ditët e sotme. Sipas subjektit të rivlerësimit, Komisioni nuk mund të kryejë këtë vlerësim në bazë të çmimit të Entit të Banesave, por duhet të kryhet nga ekspertë vlerësues për ushtrimin e këtij aktiviteti, si: bankat, ZVRPP, gjykata, prokuroria etj. Kontrata është lidhur nga dy palët dhe ka fuqinë e ligjit për palët, sipas neneve 690 dhe 691 të Kodit Civil.
22. Për sa i përket vlerës së punimeve për rikonstrukcion të godinës, subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni nuk merr parasysh provat e sjella nga vetë subjekti dhe hamendëson në nxjerrjen e konkluzioneve. Subjekti i rivlerësimit ka sjellë prova të cilat provojnë se pagesa është bërë *cash* ndaj firmës së ndërtimit, e ndarë në kohë në vitet 2011-2012, e marrë nga Banka Credins. Arsyetimi se me pagesën e punimeve me para në dorë është fshehur vlera reale e investuar për rikonstrukcion, është jologjik.
23. Në lidhje me konstatimin e problemeve të gjetura nga Komisioni për arredimin e godinës dhe kthimin në lokal shërbimi, subjekti i rivlerësimit pretendon se e ka provuar me prova shkresore se investimi nuk është kryer as nga subjekti vetë dhe as nga bashkëshorti i saj, por nga qiramarrësi shoqëria “{***}”. Këtë fakt e provon aktmarrëveshja midis bashkëshortit të subjektit dhe shoqërisë “{***}”.

24. Subjekti i rivlerësimit pretendon se për objektin verandë, Komisioni ka perceptuar gabim provat, pasi ky objekt nuk është përshtatur e ndërtuar në vitin 2012 nga subjekti dhe bashkëshorti i saj, por në vitin 2014 nga qiramarrësi, shoqëria “{***}”, me shpenzimet e saj. Për kryerjen e këtij ndërtimi është miratuar leja përkatëse nga Bashkia Korçë, bashkë me projektin ndërtimor “Autorizim për kryerje punimesh mirëmbajtjeje, datë 10.11.2014”. Sipas subjektit, kjo shtesë është kryer nga qiramarrësi dhe nuk ka ndikuar as në shtimin dhe as në pakësimin e vlerës së ndërtimit, duke qenë se është provizore.
25. **Lidhur me pasurinë “njësi me sipërfaqe 519 m², ndodhur në Korçë”,** subjekti i rivlerësimit pretendon se konstatimi i Komisionit për shkëmbimin e vlerës së transaksioneve dhe fshehjen e vlerës reale të pasurisë “njësi, me sipërfaqe 519 m²”, me qëllim fshehjen e burimit të ligjshëm financiar për krijimin e saj, është i pabazuar. Konstatimi se ndërtimi ishte një qendër tregtare dhe se njësia e përfituar ishte njësi tregtare, është i qëllimtë, sipas subjektit.
26. Subjekti i rivlerësimit kundërshton konstatimin e Komisionit në lidhje me burimin e ligjshëm të blerjes së 8% të aksioneve në shoqërinë “{***}”, sipas të cilit ekziston mungesa e dokumentacionit ligjor provues, deklaram i rremë dhe mungesë ligjshmërie e burimit të krijimit të shumave të marra hua, pa kryer analizë të provave të paraqitura nga subjekti. Sipas subjektit, huaja ashtu siç është deklaruar në DIPP-në e vitit 2003, është marrë nga shtetasi A.B., shuma 5.000.000 lekë, dhe nga prindërit, shuma 1.000.000 lekë.
27. Gjithashtu subjekti i rivlerësimit pretendon se, përveç vërtetimeve të pagave të prindërve të lëshuara nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore (në vijim “DRSSh”) Korçë, ka paraqitur edhe deklaratat me shkrim dore për dhënien hua të shumave të ndryshme të të hollave nga shtetasi V.B., çka vërtetojnë se kanë pasur të ardhura të mjaftueshme, të cilat vijnë nga një burim i ligjshëm, siç është kontrata e huas e rregulluar nga neni 1050 i Kodit Civil.
28. Në lidhje me konstatimin e Komisionit në vendim, për fshehjen e pjesës takuese të fitimit në shoqërinë “{***}”, mungesën e dokumentacionit ligjor për të vërtetuar ligjshmërinë e të ardhurave nga fitimi i krijuar gjatë viteve 2007-2009, subjekti pretendon se shoqëria nuk ka ndarë në asnjë vit dividendë, por fitimi me vendim të ortakëve ka shkuar për rritjen e kapitalit, dhe nga ana tjetër kompania e ka paguar tatim fitimit për masën e fitimit të realizuar.
29. **Lidhur me konstatimet për shumat e padeklaruara të subjektit dhe bashkëshortit të saj,** subjekti i rivlerësimit në ankimin e saj kundërshton përfundimin e Komisionit në lidhje me mosdeklarimin e shumës 2.000.000 lekë, duke shpjeguar se e ka provuar me dokumente shkresore se kjo shumë i është dhuruar bashkëshortit të subjektit nga babai i tij në vitin 2008, shumë e cila kishte qenë më parë e investuar nga ky i fundit në bono thesari në Bankën e Shqipërisë.
30. Lidhur me llogarinë e bashkëshortit në Credins Bank, sipas subjektit të rivlerësimit, kjo vlerë nuk i takonte as asaj dhe as bashkëshortit të saj, por një mikeje të familjes, saktësisht znj. E.Dh., deklarata e së cilës nuk u mor parasysh nga Komisioni. Shuma e sipërcituar është tërhequr përsëri prej znj. Dh., që është edhe pronare e shumës. Sikur të ishte e subjektit, duhet të vërtetohej që kjo shumë është përdorur diku apo është fshehur diku, pasi veprimet bankare janë

të gjitha të regjistruara.

31. Lidhur me depozitën në emër të bashkëshortit të subjektit për krijimin e shumës 10.323 euro, sipas subjektit, Komisioni ka shkëlur ligjin, sepse është deklarata *vetting* ajo që pasqyron pasuritë e subjektit të rivlerësimit dhe deklarata e personit që mbart detyrim për deklarim pasurie (në vijim “deklarata para fillimit të detyrës”) e vitit 2003 nuk është objekt hetimi. Subjekti më tej shton se edhe sikur të ishte pjesë e hetimit deklarata para fillimit të detyrës e vitit 2003, përsëri nuk do të kishim fshehje të pasurisë, sepse shuma e pretenduar si e fshehur ka qenë në llogaritë bankare të bashkëshortit të subjektit dhe përfaqëson vlerën e kthyer të kredisë së marrë për blerjen e banesës, e cila ka kaluar në depozitë kursimi dhe më pas është tërhequr nga banka përkatëse pas përfundimit të kësaj kontrate.
32. Lidhur me depozitimim *cash* të shumës 12.045 USD në NBG Bank dhe transfertën në {***} të kësaj shume, sipas ankimit të subjektit të rivlerësimit, shuma që është transferuar ka qenë një pagesë e bashkëshortit të subjektit, lindur nga një detyrim i krijuar vite më parë. PAGESA është kryer nga të ardhurat e bashkëshortit të subjektit nga puna dhe kursime familjare. Sipas subjektit të rivlerësimit, duke qenë se ky veprim është kryer në vitin 2002, nuk kishte arsye përse të deklarohet në deklaratën para fillimit të detyrës të vitit 2003. Ligji nr. 9049, datë 10.04.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë” (në vijim “ligji nr. 9049/2003”) i ndryshuar, përcakton se deklarimi i parë ngarkon subjektet të deklarojnë në çastin e hyrjes në fuqi të ligjit pasuritë e akumuluar, detyrimet financiare, burimet dhe origjinën e tyre. Gjithashtu, sipas subjektit, nuk ka asnjë kolonë në deklaratën para fillimit të detyrës të vitit 2003, ku mund të deklarohet një detyrim i plotësuar.
33. Lidhur me depozitimim e shumës prej 3.600.000 lekësh *cash* në Credins Bank, sipas ankimit, në kundërshtim me qëndrimin e Komisionit, subjekti shpjegon se veprimet e kryera në bankë lidhur me shumën 3.600.000 lekë, janë brenda së njëjtës ditë, 17 gusht 2007, si hapja e llogarisë, këmbimi dhe tërheqja e shumës, ndaj kjo e fundit nuk i përkiste bashkëshortit të subjektit, por z. L.L., i cili ushtron veprimtari tregtare në qytetin e Korçës. Subjekti i rivlerësimit pretendon se llogaria është mbyllur automatikisht në datën 02.10.2007, pasi nuk ka pasur fonde për të paguar komisionin e saj, por shuma është tërhequr në datën 17.08.2007, dhe jo siç i rezulton Komisionit.
34. Lidhur me të ardhurat e bashkëshortit të subjektit, të realizuara nga kontrata e qirasë me shoqërinë “{***}”, subjekti i rivlerësimit deklaroi se ka provuar me dokumentacion, si kontrata e qirasë dhe vërtetimi i Drejtorisë Rajonale të Tatimeve (në vijim “DRT”) Korçë, pagesën e vlerës së tatimit në burim. Gjithashtu pretendon se vlerat e deklaruara janë të sakta në deklaratën *vetting* dhe për këtë të ardhur është vërtetuar para Komisionit se janë paguar detyrimet tatimore në shtet, pra plotësohen të gjitha kërkesat e nenit D të Aneksit të Kushtetutës.
35. Lidhur me vlerën e investuar nga shoqëria “{***}” për arredimin e kthimin në lokal shërbimi të objektit, subjekti i rivlerësimit shpjegon se investimi në godinë ka ardhur si pasojë e një marrëveshjeje midis kësaj shoqërie dhe bashkëshortit të subjektit, e cila specifikon se shoqëria

do të kryente punimet dhe përshtatjen e godinës në lokal shërbimi dhe, për këtë arsye, nuk do të paguante qira për periudhën prill-dhjetor 2013. Subjekti shpjegon se nuk ka qenë detyrim i tij të dinte se sa është vlera e punimeve, për sa kohë sipas marrëveshjes nuk ishin të kompensueshme dhe kjo mosdijeni nuk mund të sjellë pasoja ndëshkuese për të.

36. Lidhur me të ardhurat nga kontrata e qirasë me shoqërinë “{***}”, subjekti i rivlerësimit kundërshton analizën e provave dhe rrethanave të sqaruara për të ardhurat e deklaruara nga subjekti, që rrjedhin nga kontratat e qirasë me shoqërinë “{***}” ShPK, të lidhura me bashkëshortin e saj, ato duhet të konsiderohen si burim i ligjshëm të ardhurash, pasi janë rrjedhojë e një kontrate qiraje të ligjshme, të vlefshme dhe të pakundërshtuar, për këto të ardhura është mbajtur tatimi në burim, sipas përcaktimeve të nenit 33 të ligjit “Për tatimin mbi të ardhurat”.
37. Për sa i përket konstatimit të Komisionit për të ardhurat e dyshimta nga qiraja me shoqërinë “{***}” për periudhën 2015-2016, subjekti i rivlerësimit pretendon se analizimi i veprimtarisë tregtare të shoqërisë është i pabazuar dhe aktiviteti i kësaj shoqërie nuk është objekt shqyrtimi i Komisionit. Sipas subjektit, pjesa e pagimit të qirasë është e paraqitur në të gjitha bilancet e shoqërisë, të administruara në dosje së bashku me pagesën e tatimit në burim.
38. Lidhur me të ardhurat nga qiraja për banesën në Bulevardin {***}, subjekti i rivlerësimit kundërshton konstatimin e Komisionit që bashkëshorti i saj ka kryer deklaram të rremë, duke shpjeguar se Komisioni nuk ka marrë në shqyrtim provat shkresore që sqarojnë plotësisht situatën. Marrëdhënia e qirasë është krijuar midis një individi si person fizik dhe bashkëshortit të subjektit, me vullnetin e tyre të lirë. Ka qenë zgjedhja e qiramarrësit që ka përcaktuar mënyrën e pagimit të vlerës së qirasë dhe kjo zgjedhje nuk ngarkon me përgjegjësi qiradhënësin. Shuma prej 2200 eurosh është e ardhur e krijuar nga një kontratë qiraje e ligjshme, për të cilën janë paguar detyrimet tatimore dhe, si e tillë, plotëson kërkesat e nenit D të Aneksit të Kushtetutës.
39. Lidhur me të ardhurat dhuratë nga prindërit e bashkëshortit të subjektit, ky i fundit kundërshton konstatimin e Komisionit si deklaram të rremë dhe mungesë burimi të ligjshëm për krijimin e tyre si tërësisht të pabazuar në provat e paraqitura nga subjekti, të cilat janë lëshuar nga organet kompetente.
40. Lidhur me denoncimin anonim për pasuri të fshehura të subjektit të rivlerësimit, subjekti pretendon se Komisioni nuk ka kryer hetim për të vërtetuar nëse denoncimi është i bazuar. Gjithashtu, për këtë rast, subjekti pretendon se kuptimi i personit të lidhur nuk është çdo person me të cilin hyn në një marrëdhënie financiare. Nuk është vërtetuar se huaja që subjekti i rivlerësimit i ka dhënë motrës, lidhet me krijimin e pasurive të saj. Pasuritë e krijuara nga motra janë për një hark të gjerë kohor prej 10 vjetësh dhe për një vlerë të konsiderueshme, ndërsa huaja prej 550000 lekësh është një shumë e vogël, krahasuar me shumën e investuar për krijimin e këtyre pasurive. Subjekti i rivlerësimit pretendon se konstatimi i Komisionit në vendim se përputhen të dhënat e adresave të denoncimit me adresat e familjarëve të subjektit nuk mund të konsiderohet si i bazuar në prova e në ligj. Subjekti pretendon se motra e saj nuk mund të konsiderohet si person i lidhur, duke e konsideruar këtë qëndrim të Komisionit si

tërësisht në kundërshtim me ligjin.

III. Vlerësimi i Kolegjit mbi procedurën e ardhjes së çështjes për shqyrtim dhe procedurave të tjera para shqyrtimit gjyqësor të ankimit në themel

41. Juridiksioni i Rivlerësimit dhe kompetenca e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit përcaktohen në nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës, e cila parashikon: *Rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, ndërsa ankimet e subjekteve të rivlerësimit ose të Komisionerit Publik shqyrtohen nga Kolegji i Apelimit pranë Gjykatës Kushtetuese, si dhe në nenin 5, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilave: 1. Procesi i vlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelimit, komisionerët publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë. 2. Kolegji i Apelimit shqyrton ankimet ndaj vendimeve të Komisionit dhe ka mandat 9-vjeçar.*
42. Procesi gjyqësor në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit (në vijim “Kolegji”) zhvillohet bazuar në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016, në përputhje me rregullat e parashikuara në nenet 47, 48/1, 49, 51 dhe 55 të ligjit nr. 49/2012.
43. Kolegji fillimisht konstatoi se subjekti i rivlerësimit, znj. Entela Prifti, legjitimohet për të ushtruar ankim në Kolegji në kuptim të nenit F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës dhe në kuptim të nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, ankimi i saj është depozituar brenda afatit ligjor.
44. Në Kolegji janë paraqitur respektivisht në datat 29.03.2019 dhe 15.04.2019, denoncime për subjektin e rivlerësimit nga z. A.H. dhe z. P.B. Pasi vlerësoi këto denoncime sipas kërkesave të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, Kolegji vendosi për mosfillimin e hetimit kryesisht për këto denoncime, pasi nuk përmbanin informacione të mjaftueshme për t’u hetuar.
45. Nëpërmjet ankimit, është kërkuar nga subjekti i rivlerësimit, znj. Entela Prifti, shqyrtimi i çështjes në seancë publike gjyqësore. Kolegji vlerësoi se debati gjyqësor në seancë gjyqësore, me praninë e palëve, është i panevojshëm, pasi: a) vlerësohet se konstatimi i gjendjes faktike është bërë nga Komisioni në mënyrë të plotë e të saktë dhe, për pasojë, nuk nevojitet vërtetimi i fakteve të reja dhe marrja e provave të reja; b) nuk konstatohen shkelje të rënda procedurale që të kenë ndikuar në vendimmarrje apo gjendje faktike e konstatuar gabim dhe në mënyrë jo të plotë nga Komisioni; c) nuk vlerësohet se është e nevojshme përsëritja e marrjes së disa apo të gjitha provave të marra në Komision, si rrjedhojë nuk jemi para kërkesave të nenit 51 të ligjit nr. 49/2012.
46. Bazuar në sa më sipër, Kolegji, pasi vlerësoi kërkesat e nenit 51 të ligjit nr. 49/2012, vendosi të zhvillojë shqyrtimin e vendimit të Komisionit, nëpërmjet ankimit të subjektit të rivlerësimit, mbi bazë dokumentesh.
47. Subjekti i rivlerësimit ka ushtruar funksionin e gjyqtares në Gjykatën e Apelit Korçë, ku ka mbajtur dhe funksionin e kryetares së kësaj gjykate në momentin e fillimit të procesit të rivlerësimit. Bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në ligjin

nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, subjekti i rivlerësimit i është nënshtruar rivlerësimit *ex officio*.

48. Gjatë hetimit administrativ, mbështetur në nenin 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, i cili parashikon: *Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit. Vendimi merret bazuar në një ose disa prej kritereve, në vlerësimin e përgjithshëm të tre kritereve, ose në vlerësimin tërësor të procedurave* – Komisioni ka administruar raportet nga institucionet kompetente në lidhje me vlerësimet e pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale. Komisioni, me vendimin nr. 1, datë 15.01.2018, vendosi të fillojë hetimin administrativ mbi procedurën e rivlerësimit.
49. Më datë 12.09.2018, me vendimin nr. 2, Komisioni ka vendosur të përfundojë hetimin kryesisht për kriterin e vlerësimit të pasurisë, për subjektin e rivlerësimit, znj. Entela Prifti. Këto rezultate iu njoftuan me postë elektronike edhe subjektit më datë 13.09.2018, duke i njoftuar njëkohësisht edhe kalimin e barrës së provës, sipas nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, të drejtën me njohjen e provave të administruara në përputhje me nenet 45-47 dhe 35-40 të Kodit të Procedurave Administrative. Më datë 27.09.2018, subjekti i rivlerësimit ka dërguar shpjegimet dhe dokumentacionin mbështetës mbi rezultatet e hetimit kryesisht pranë Komisionit.
50. Seanca dëgjimore është zhvilluar në Komision më datë 08.10.2018, në prezencë të subjektit të rivlerësimit, znj. Entela Prifti, e cila ka parashtruar shpjegimet përkatëse për rezultatet e hetimit kryesisht, si dhe për procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj.
51. Inspektorati i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”), në përfundim të veprimeve verifikuese të tij, nëpërmjet raportit të hollësishëm dhe të arsyetuar, ka bërë analizimin e të dhënave të deklaruara nga subjekti, mbështetur në aktet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit dhe informacionet e ardhura nga institucionet e specializuara, dhe ka arritur në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit: a) deklarimin nuk e ka të saktë dhe në përputhje me ligjin; b) nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë; c) ka kryer fshehje të pasurisë; ç) ka kryer deklarim të rremë; d) nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.
52. Më datë 10.10.2018, është zhvilluar seanca publike për shpalljen e vendimit. Komisioni me vendimin nr. 69, datë 10.10.2018, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit, si dhe pasi shqyrtoi të gjitha pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti, ka arritur në përfundimin që subjektit të rivlerësimit, znj. Entela Prifti, gjyqtare në Gjykatën e Apelit Korçë, t’i jepet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra.
53. Kundër këtij vendimi ka paraqitur ankim brenda afatit ligjor subjekti i rivlerësimit, znj. Entela Prifti, me anë të të cilit kërkon prishjen e vendimit nr. 69, datë 10.10.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit dhe konfirmimin në detyrë, duke parashtruar në ankimin e saj vetëm shkaqet mbi të cilat mbështeten pretendimet e saj.

IV. Vlerësimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, lidhur me thelbin e ankimit

54. Në lidhje me shkaqet e ankimit për procesin e rregullt ligjor, subjekti i rivlerësimit pretendon në ankim se vendimi objekt shqyrtimi është marrë:
- në shkelje të të drejtave personale e ligjore të parashikuara nga KEDNj-ja;
 - në shkelje të ligjit procedural;
 - në interpretim të gabuar, dashakeqës, subjektiv të provave dhe rrethanave;
 - në mungesë të një analize të provave e fakteve;
 - në kushte të një procesi të parregullt, duke u paragjykuar dhe duke u cenuar nga sjellja e komisionerëve;
 - në shkelje të parimeve të objektivitetit dhe proporcionalitetit;
 - në cenim të figurës dhe personalitetit të subjektit dhe cenimit të të drejtave të personave të tretë.

54.1 Lidhur me sa më sipër, sa i përket shkakut të ankimit për shkelje të të drejtave personale e ligjore, ndryshe nga sa pretendon subjekti i rivlerësimit, Kolegji vlerëson se ky pretendim nuk qëndron. Kolegji vëren që subjekti i rivlerësimit nuk ka identifikuar në mënyrë të posaçme cilat të drejta i janë cenuar gjatë procesit të rivlerësimit në Komision. Aneksi i Kushtetutës, në nenin A të tij ka parashikuar kufizime të të drejtave kushtetuese dhe saktësisht në paragrafin e parë të këtij neni parashikon: *Me qëllim kryerjen e procesit të rivlerësimit, zbatimi i disa neneve të kësaj Kushtetute, veçanërisht i neneve që lidhen me të drejtën për respektimin e jetës private, si dhe nenet 36 dhe 37, dispozitat që lidhen me barrën e provës, nenet 128, 131, nënparagrafi “f”, 135, 138, 140, 145, paragrafi 1, 147/a, paragrafi 1, nënparagrafi “b”, 149/a, paragrafi 1, nënparagrafi “b”, kufizohen pjesërisht, sipas nenit 17 të Kushtetutës.* Nga ana tjetër, neni 17 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikon se kufizimet e të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve, në një raport të pranueshëm nga Aneksi i Kushtetutës.

54.2 Gjithashtu, duke iu referuar vetë ligjit nr. 9887, datë 10.03.2008, “Për mbrojtjen e të dhënave personale”, në nenin 4, pika 4, germa “b” e tij, parashikohet se: *ky ligj nuk zbatohet për përpunimin e të dhënave vetëm për rastet kur jepet informacion për persona publikë zyrtarë ose punonjës të administratës publike (shtetërore), nëpërmjet të cilit pasqyrohet aktiviteti publik, administrativ ose çështje lidhur me detyrën e tyre.* Pra, përpunimi i të dhënave personale dhe mbrojtja e tyre gjen kufizim nga Kushtetuta, Aneksi i Kushtetutës dhe, në raste të caktuara, edhe nga vetë ligji nr. 9887, duke i parashikuar si raste përjashtimore të mbrojtjes së të dhënave personale për subjektet e rivlerësimit.

54.3 Konstatohet gjithashtu se Komisioni gjatë hetimit administrativ i ka zbatuar parimet e procesit të rregullt ligjor. Konkretisht, rezulton se subjektit i është dhënë mundësia dhe i është garantuar e drejta e paraqitjes së provave dhe shpjegimeve; nuk rezulton se anëtarët e Komisionit janë treguar të anshëm dhe paragjykues gjatë kryerjes së procesit të rivlerësimit, rezulton se është garantuar edhe parimi i ligjshmërisë; nuk rezulton i vërtetuar një interpretim ligjor i gabuar, me qëllim rëndues për subjektin, apo të jetë cenuar parimi i “objektivitetit” i “proporcionalitetit” apo i “barazisë së armëve”. Gjithashtu, nuk rezultojnë të vërtetuara

pretendimet e subjektit për një mënyrë gjykimi subjektive, të njëanshme, qëllimisht rënduese për të, apo denigruese për subjektin e rivlerësimit dhe personat e lidhur.

54.4 Procesi i rregullt ligjor, i sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës dhe nenin 6 të KEDNj-së, rezulton se i është garantuar subjektit të rivlerësimit. Kolegji konstaton se subjekti i rivlerësimit, gjatë procesit administrativ në Komision, nuk ka ngritur pretendime në lidhje me procesin e rregullt ligjor. Neni 42, pika 2 e Kushtetutës parashikon, ndër të tjera, se: *Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetues dhe ligjorë, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj* (dispozitë kjo në harmoni me KEDNj-në). Kjo dispozitë kushtetuese nuk rezulton të jetë shkelur nga Komisioni në procesin e rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit, znj. Entela Prifti.

55. Lidhur me pretendimin e subjektit se Komisioni e ka bazuar tërësisht gabim vendimin në pikën 5 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, e cila i referohet pikës 2 të nenit 4 të po këtij ligji, pasi Komisioni nuk provoi pse subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut të drejtësia, pasi ky cenim lidhet me dy kritere të tjera të rivlerësimit, konkretisht figura dhe profesionalizmi, të cilat në rastin konkret janë tërësisht të pashqyrtuara, Kolegji arsyeton si vijon.

55.1 Në analizë të këtij pretendimi të subjektit të rivlerësimit, duke iu referuar vlerësimit tërësor të procedurave, ku në nenin 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016 parashikohet se: *Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit. Vendimi merret bazuar në një ose disa prej kritereve, në vlerësimin e përgjithshëm të tri kritereve, ose në vlerësimin tërësor të procedurave, në funksion të nenit 61, paragrafi 5 i këtij ligji, del e qartë që institucionet e rivlerësimit mund të vendosin mbi bazën e një kriteri vlerësimi ose të disa kritereve vlerësimi, si dhe në vlerësimin e tri kritereve apo në vlerësimin e përgjithshëm të tyre, ose në vlerësimin tërësor të procedurave mbi bazën e një ose disa kritereve të rivlerësimit, qëndrim ky i mbajtur në jurisprudencën² e Kolegjit. Komisioni dhe Kolegji kanë të drejtë për të konkluduar me vendim qoftë edhe vetëm për njërin nga kriteret dhe, bazuar në nenin D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, konkretisht për kriterin e pasurisë, Kushtetuta parashikon shkarkimin nga detyra për ato raste të deklarimit të pasurisë të parashikuara në këtë dispozitë, siç është përpjekja për të fshehur apo paraqitja në mënyrë të pasaktë e pasurive.*

56. Në lidhje me pretendimin në ankim se vendimi objekt shqyrtimi ka karakterin e një dënimi penal dhe me fuqi prapavepruese, si dhe shkalla e ashpërsisë së këtij vendimi ndalon në mënyrë permanente dhe fitimin e titullit “avokat”, Kolegji arsyeton si vijon.

56.1 Kolegji vëren se neni Ç, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës në veçanti dhe tërësia e dispozitave të ligjit nr. 84/2016, e përjashtojnë kategorikisht dhënien e masës disiplinore sipas këtij procesi administrativ të rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, në formën e një dënimi penal apo karakteri të një dënimi penal. Dënimet për kryerjen e veprave penale përcaktohen nga legjislacioni penal. Në legjislacionin shqiptar, sjelljet e individit (veprimet a

² *Vendimi i Kolegjit nr. 9/2018 (JR), paragrafi 44; vendimi i Kolegjit nr. 15/2019 (JR), paragrafi 119; vendimi nr. 11/2018 (JR), paragrafi 5; vendimi nr. 2/2019 (JR), paragrafi nr. 35.2.*

mosveprimet) që konsiderohen si vepra penale, si dhe dënimet përkatëse për to, janë të parashikuara në mënyrë të shprehur në Kodin Penal, i cili përbën bazën e garantimit dhe respektimit të parimit themelor të ligjshmërisë në të drejtën penale, të garantuar në Kushtetutë dhe të parashikuar me ligj. Ndërsa qëllimi i ligjit nr. 84/2016 është përcaktimi i rregullave të posaçme për rivlerësimin kalimtar të të gjitha subjekteve të rivlerësimit për të garantuar funksionimin e shtetit të së drejtës, pavarësinë e sistemit të drejtësisë, si dhe rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi, sipas parashikimeve të nenit 179/b të Kushtetutës. Objekti i vlerësimit të pasurisë është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij.

56.2 Dispozitat kushtetuese dhe ligjore të posaçme që rregullojnë procesin e rivlerësimit për kriterin e pasurisë, në asnjë rast nuk e lidhin pamjaftueshmërinë e deklarimit me elementet subjektive të dashjes apo qëllimit në kuptimin penal të këtyre instituteve. Në këtë proces, subjektit të rivlerësimit, bazuar në nenin D të Aneksit të Kushtetutës, i duhet të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurive dhe të të ardhurave dhe nuk duhet të fshehë ose të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, posedim ose në përdorim të tij dhe organet e rivlerësimit kanë si qëllim që të identifikojnë ata që kanë në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikohen ligjërisht, ose ata që nuk i kanë deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e tyre dhe të personave të lidhur. Në shtojcën 2 të ligjit nr. 84/2016, në pjesën informuese të deklaratës së pasurisë për procesin e rivlerësimit, subjektet e rivlerësimit janë informuar mbi sanksionet administrative me pasojë shkarkimin nga detyra, në rast mosplotësimi me saktësi dhe vërtetësi të saj. Nga ana tjetër, rivlerësimi është analizë e së shkuarës së një funksionari publik, duke mbajtur në konsideratë që objekt kontrolli është pasuria dhe për këtë shkak institucionet e rivlerësimit kontrollojnë burimin (në të shkuarën) për të cilin është krijuar kjo pasuri. Rivlerësimi (*vetting*) mund të përkufizohet si vlerësim i integritetit për të përcaktuar përshtatshmërinë për funksione publike³.

Ndryshe nga sa pretendon në ankim subjekti i rivlerësimit, Kolegji arsyeton se procesi i rivlerësimit është një procedurë administrative/sanksionuese, e cila ofron të gjitha garancitë e një procesi të rregullt ligjor dhe nuk qëndron shkaku i ankimit se vendimi i marrë nga Komisioni ka karakterin e një procesi penal⁴.

56.3 Edhe Komisioni i Venecias në Opinionin [*Amicus Curiae*] për ligjin e *vetting*-ut, në paragrafin 41 shprehet: *Neni Ç i Aneksit të Kushtetutës, në paragrafin 2 të tij, vendos shprehimisht mbi Komisionin e Pavarur dhe Kolegjin e Apelimit detyrimin për të garantuar të drejtat e procesit të rregullt ligjor. Po ashtu, ndonëse në procesin e rivlerësimit, në disa raste, mund të zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit dhe subjektit të rivlerësimit i takon barra për të provuar të kundërtën, neni Ç i Aneksit të Kushtetutës parashikon qartë se kjo zbatohet vetëm për procedurën e rivlerësimit dhe jo për procedurat e tjera, dhe veçanërisht jo për procedurat penale*⁵.

³ Vendimi i Kolegjit nr. 19/2019 (JR), paragrafi 39.

⁴ Vendimi i Kolegjit nr. 9/2018 (JR), paragrafi 44, vendimi i Kolegjit nr. 2/2019 (JR), paragrafi 48.1.

⁵ Vendimi i Kolegjit nr. 10/2018 (JR), paragrafi 40.2.

56.4 Neni 61 i ligjit nr. 84/2016 parashikon: *Shkarkimi nga detyra i subjekteve të rivlerësimit jepet si masë disiplinore në këto raste [...]*, duke parashikuar 5 pikat e problematikave që e çojnë një subjekt rivlerësimi drejt masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, çka do të thotë se subjektet e rivlerësimit të cilët marrin masën disiplinore të shkarkimit nga detyra, nuk e kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit.

56.5 Sa i përket pretendimit tjetër në ankim në lidhje me fuqinë prapavepruese, si dhe shkallën e ashpërsisë së këtij vendimi, i cili ndalon në mënyrë permanente dhe fitimin e titullit “avokat”, Kolegji këtë shkak ankimi nuk e sheh relevant me çështjen në shqyrtim dhe e sheh atë jashtë juridiksionit të Kolegjit.

- 57.** Subjekti i rivlerësimit pretendon në ankim se procesi i rivlerësimit i shoqëruar me barrën e provës ndaj subjektit të rivlerësimit, është në shkelje të nenit 6/1 të KEDNj-së. Në këtë këndvështrim, subjekti, duke iu referuar Protokollit 16 të KEDNj-së, kërkon nga Kolegji t'i drejtohet GjEDNj-së për marrjen e opinionëve të mëposhtme.
- a) Procesi kalimtar i vlerësimit të gjyqtarëve e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, në rast se kryhet vetëm për një kriter, atë të vlerësimit të pasurisë, a përbën shkelje të nenit 6 të KEDNj-së dhe, në përgjithësi, të standardeve të pavarësisë së gjyqësorit?
 - b) Kryerja e procedurave hetimore mbi bazën e deklaratës *vetting* të gjyqtarëve dhe kalimi të këta të fundit i barrës së provës, a është në përputhje me jurisprudencën e nenit 6/1 të KEDNj-së dhe të parimit të mosinkriminimit (*self-incrimination*)?
 - c) Masat e marra nga organet respektive të ngritura në procesin e vlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, a mund të konsiderohen për konceptin “autonomy” të Konventës si “sanksion me natyrë penale”, për të cilin ndalohet zbatimi për to me efekt prapaveprues?

57.1 Duke e vlerësuar të padrejtë kërkimin e subjektit, për pretendimet e mësipërme për marrjen e opinionit GjEDNj-së, Kolegji arsyeton se:

- a-i) Procesi kalimtar i vlerësimit të gjyqtarëve e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë, tashmë e ka jurisprudencën e vet me gjykimet në Kolegji, ku në interpretim të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, vendimet merren bazuar edhe vetëm për një kriter, atë të vlerësimit të pasurisë (shih paragrafin 55.1 më sipër).
- b-i) Kalimi i barrës së provës vetëm në këtë proces është konsideruar dhe konsiderohet në përputhje me nenin 6/1 të KEDNj-së dhe respekton dhe garanton parimin e mosinkriminimit⁶ (shih paragrafin 56.2 më sipër).
- c-i) Masa disiplinore, sipas procesit të rivlerësimit kalimtar, nuk është dënim penal dhe nuk ka vend për të diskutuar për efektet prapavepruese të ligjit nr. 84/2016, në kuptim të nenit Ç, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës (shih paragrafin 56.3 më sipër).

- 58.** Subjekti i rivlerësimit, znj. Entela Prifti, nëpërmjet ankimit, kërkoi shqyrtimin e çështjes në seancë publike me praninë e palëve, për të mundësuar dëgjimin e saj dhe krijimin e një bindjeje më të plotë se në Komision.

⁶ [file://server1/folder_redirection\\$VeniceCommissionOpinionVL.pdf](file://server1/folder_redirection$VeniceCommissionOpinionVL.pdf)

58.1 Në lidhje me kërkimin e subjektit në ankim për shqyrtimin e çështjes në seancë publike, Kolegji çmon se gjendet i pabazuar, pasi rezulton se kjo e drejtë i është respektuar nga Komisioni në seancën dëgjimore dhe subjekti ka ushtruar të drejtën e paraqitjes së provave dhe shpjegimeve në Komision. Për më tepër, në përputhje me nenin 49, pika 1 e ligjit nr. 49/2012, gjykimi në apel, si rregull, bëhet mbi bazë dokumentesh, në dhomë këshillimi.

58.2 Përveç sa më sipër, Kolegji nuk e çmoi të nevojshëm shqyrtimin e çështjes në seancë gjyqësore publike për t'i dhënë mundësi subjektit për t'u dëgjuar edhe në Kolegji. Kjo edhe për faktin se kërkitimi/argumenti që paraqet subjekti i rivlerësimit për kalimin e çështjes në seancë publike nuk parashikohet në rastet specifike ligjore, sipas kërkesave të nenit 51 të ligjit nr. 49/2012. Për më tepër, Kolegji vlerësoi se: a) konstatimi i gjendjes faktike është bërë nga Komisioni në mënyrë të plotë dhe të saktë dhe, për pasojë, nuk nevojitet vërtetimi i fakteve të reja dhe marrja e provave të reja; b) nuk konstatoi shkelje të rënda procedurale që të kenë ndikuar në vendimmarrje, apo gjendje faktike të konstatuar gabim dhe në mënyrë jo të plotë nga Komisioni; c) nuk vlerësoi se është e nevojshme përsëritja e marrjes së disa apo të gjitha provave të marra në Komision.

Sa më sipër, Kolegji vlerëson se pretendimet e mësipërme të subjektit, në lidhje me procesin e rregullt ligjor, të ngritura në ankim nga subjekti i rivlerësimit, nuk qëndrojnë dhe, për pasojë, janë të pabazuara në ligj.

V. Shkaqet e ankimit lidhur me vlerësimin e kriterit të pasurisë dhe analizimi i tyre

*Lidhur me pasurinë “apartament banimi me sipërfaqe 55 m², me nr. pasurie {***}, regjistruar me certifikatën e pronësisë nr. {***}, lëshuar me datë 04.10.2012, fituar me anë të kontratës së shitjes nr. {***} rep., {***} kol., datë 18.09.2012, me adresë rr. “{***}” Korçë”, pasuri bashkëshortore me vlerë 2.835.500 lekë”, Kolegji konstaton si më poshtë.*

59. Subjekti i rivlerësimit pretendon se nuk ka kryer fshehje të pasurisë, siç ka rezultuar në Komision, me arsyetimin se bashkëshorti i saj si person i lidhur nuk ka deklaruar pasurinë e përbashkët, e cila është deklaruar nga njëri bashkëshort, ndaj si person i lidhur ka pasur detyrimin të deklarojë vetëm pasuritë e regjistruara veçmas nga subjekti i rivlerësimit. Sipas subjektit, deklarimi i mësipërm duhet të konsiderohet i saktë dhe i plotë.

59.1 Në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se ka në pronësi një apartament me sipërfaqe 55 m², me të dhënat siç janë përshkruar më sipër, fituar me anë të veprimit juridik kontratë shitjeje, ndërsa personi i lidhur (bashkëshorti i subjektit) nuk e ka deklaruar në rubrikën e tij pasurinë për pjesën takuese. Komisioni, në vendimin e tij, ka konsideruar faktin e mosdeklarimit të bashkëshortit të subjektit, pjesën takuese prej 50%, si fshehje të pasurisë nga ana e personit të lidhur/bashkëshortit.

59.2 Në DIPP-në e vitit 2012, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: “blerje apartament banimi 55 m², rr. “{***}”, Korçë, kontratë shitjeje nr. {***} rep., dhe {***} kol, datë 18.09.2012, me pjesë takuese 50%. Kjo kontratë është lidhur nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit dhe është regjistruar në emër të subjektit dhe bashkëshortit të subjektit. Po ashtu, në deklarimin e vitit 2012 të personit të lidhur, është deklaruar pasuria me pjesë takuese 50%. Duke qenë se

kjo pronë është regjistruar dhe deklaruar nga personi i lidhur në DIPP-në e vitit 2012, si dhe nga subjekti i rivlerësimit, znj. Entela Prifti, e cila *de jure* përfiton nga bashkësia ligjore si pasuri pasmartesore, Kolegji konstaton se në rrethanat konkrete nuk rezulton të kemi të bëjmë me fshehje pasurie. Ka pasaktësi në deklarim nga ana e bashkëshortit të subjektit në deklaratën *vetting*, por nuk konsiston në fshehjen e pasurisë, aq më tepër që subjekti e ka deklaruar këtë pasuri. *Sa më sipër, shkaku i ngritur nga subjekti është i bazuar.*

60. Subjekti i rivlerësimit pretendon se vendimi i Komisionit, në lidhje me konstatimet e mungesës së burimeve financiare dhe deklarimit të rremë për pasurinë e sipërcituar, janë të gabuara dhe në kundërshtim me provat e paraqitura nga subjekti. Për krijimin e kësaj pasurie, kanë shërbyer të ardhurat familjare nga kursimet dhe një pagesë prej 1.600.000 lekësh, e kryer *cash* nga ana e babait të bashkëshortit të subjektit. Subjekti pretendon gjithashtu se nëpërmjet dokumentacionit të sjellë, ka provuar mundësinë e pagimit nga babai i bashkëshortit të shumës së mësipërme.

60.1 Kolegjit, në analizën e tij, i rezultoi se të ardhurat e përfituara nga pensioni për z. B.T., babai i bashkëshortit të subjektit, nga viti 2008 deri në qershor të vitit 2012 (kur është ndarë nga jeta), janë në vlerën 704.490 lekë. Të ardhurat e përfituara nga pensioni i pleqërisë për znj. F.T., nëna e bashkëshortit të subjektit, nga janari i viti 2008 deri në korrik të vitit 2008 (kur është ndarë nga jeta), janë në vlerën 71.982 lekë. Të dy prindërit e bashkëshortit të subjektit kanë investuar në bono thesari nga viti 2002 deri në vitin 2008 vlerën 2.000.000 lekë. Në këto kushte, duke qenë se të ardhurat totale janë në vlerën 776.472 lekë, investimi në bono thesari në vlerën 2.000.000 lekë, dukshëm rezulton se të ardhurat e përfituara nga prindërit e bashkëshortit nuk janë të mjaftueshme për përballimin e shpenzimeve të jetesës, si dhe krijimin e kursimeve dhe investimin e këtyre shumave në bono thesari.

60.2 Gjithashtu, për sa u përket vlerave të investuara në bono thesari të prindërve të bashkëshortit të subjektit, këto vlera janë transferuar në llogarinë e djalit të tyre, z. P.T., disa vite përpara blerjes së kësaj pasurie. Sipas vërtetimit të Bankës Credins, dega Korçë, me nr. {***} prot., datë 26.03.2009, vërtetohet se në llogarinë e bashkëshortit të subjektit janë depozituar dy shuma, në vlerat 974.451 lekë dhe 951.931 lekë, nga bonot e thesarit të cilat kanë qenë në emër të prindërve të tij. Sipas pasqyrës së gjendjes së llogarisë të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit në Credins Bank, rezulton se këto shuma janë depozituar nga prindërit më datë 26.11.2008, dhe pas disa veprimeve të kryera prej tij janë tërhequr përfundimisht bashkë me një shumë tjetër në datën 19.03.2009, datë kjo me diferencë në kohë me datën e blerjes së kësaj pasurie (2012).

60.3 Lidhur me të ardhurat e pretenduara nga subjekti i rivlerësimit si të përfituara nga qiraja e apartamentit të vajzës së z. B.T., nuk u arritën të provohen me ndonjë kontratë qiraje apo dokumente nga institucionet zyrtare. Subjekti i rivlerësimit shpjegoi se për shkak të kohës së gjatë të kaluar nuk gjendet asnjë kontratë, por vlera mujore e qirasë në nivel deklarativ, sipas subjektit, ka qenë 50.000 dhrahmi. Për sa u përket këtyre të ardhurave, rezulton se nuk është provuar dhe shpjeguar bindshëm nga subjekti i rivlerësimit sa kanë qenë të ardhurat dhe a është paguar tatimi në burim për këtë qiradhënie.

60.4 Gjithashtu, lidhur me burimin tjetër të krijimit të shumës 1.600.000 lekë, ku subjekti ka deklaruar të ardhurat nga shitja e shtëpisë së vajzës së z. B.T., nuk është paraqitur asnjë dokument provues se ku janë mbajtur këto mjete financiare nga z. B.T. që nga viti 2000, momenti i shitjes së shtëpisë së vajzës, deri në vitin 2012 kur është bërë blerja e pasurisë nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, duke e bërë të pabesueshëm pretendimin e subjektit të rivlerësimit, znj. Entela Prifti, për zotërimin nga ana e babait të bashkëshortit të saj të kësaj shume parash.

Sa më sipër, shkaku i ankimit nuk është i bazuar në prova.

- 61.** Subjekti i rivlerësimit pretendon se Komisioni nuk ka pranuar se një pjesë e kursimeve të krijuara nga prindërit e bashkëshortit ka ardhur edhe nga shitja e shtëpisë së vajzës së tyre, në shumën 1.800.000 lekë, fakt që nuk u konsiderua nga Komisioni vetëm për arsyen se nuk kishte një provë shkresore për këtë dhurim, duke qenë se kontrata e dhurimit mund të bëhet edhe me gojë sipas Kodit Civil, neni 761 e vijues. Detyrim është të lidhet kontratë noteriale vetëm në rastin e kalimit të pasurisë së paluajtshme.

61.1 Kolegji, lidhur me shumën që subjekti deklaron se babai i bashkëshortit e ka marrë nga shitja e apartamentit të së bijës në vitin 2002, në vlerën 1.800.000 lekë, konstatoi se në kontratën e shitjes së këtij apartamenti me nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 06.06.2002, citohet se pagesa është kryer jashtë zyrës noteriale, por nuk ka asnjë dokument tjetër që të provojë se kjo shumë i është dhënë dhuratë babait të bashkëshortit nga vajza e tij.

61.2 Në vendimin nr. 23/2002 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, në pjesën arsyetuese, pika 3, argumentohet: *Ndërsa kontrata e shitjes ka karakter konsensual, kontrata e dhurimit është konsideruar si kontratë reale, domethënë ajo **quhet e lidhur në çastin e dorëzimit të sendit të luajtshëm apo të paluajtshëm, që përbën objektin e saj (neni 764 i Kodit Civil) [...].*** Në nenin 764, paragrafi 3, parashikohet se kur akti i dhurimit ka për objekt sende të luajtshme, ai është i vlefshëm kur ato specifikohen duke treguar edhe vlefshësinë e tyre në kontratën e dhurimit. Për shkak të të gjitha rrethanave të çështjes, mungesës së një dokumentacioni shkresor, Kolegji nuk bindet për vërtetësinë e pretendimeve të subjektit.

Pretendimi i subjektit për këtë shkak nuk është i bazuar në ligj dhe në prova.

- 62.** Subjekti i rivlerësimit pretendon se transfertat e kryer nga ana e bashkëshortit në {***}, ShBA, nuk ka lidhje me shumën e shitjes së banesës së motrës së bashkëshortit. Për të gjitha këto arsye, subjekti mendon se deklarimi për burimin e kësaj pasurie duhet të vlerësohet i rregullt, pasi bazohet në faktin se prona është krijuar me burime të ligjshme të ardhurash. Komisioni, qëllimisht, për të dëmtuar interesat e subjektit, ka bashkuar dy situata financiare në një, konkretisht transfertën bankare të kryer nga bashkëshorti i subjektit nga llogaria e tij në NBG Bank Korçë, drejt llogarisë bankare të z. P.B. në {***}, Miçigan, e konsideruar si një debi e vitit 2002, për të cilën Komisioni ka vlerësuar se lidhet me shumën e shitjes së banesës së motrës së bashkëshortit.

62.1 Kolegji vëren se me kontratën nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 06.06.2002, bashkëshorti i subjektit, si përfaqësues me prokurë, ka shitur shtëpinë e motrës së tij, znj. M.B., dhe bashkëshortit të saj, z. P.B., me çmimin 1.800.000 lekë. Ditën e nesërme, më datë

07.06.2002, bashkëshorti i subjektit ka bërë transferimin e shumës 12045 USD nga NBG Bank, dega Korçë, në llogarinë e burrit të motrës, z. P.B., me përshkrimin “huadhënie personale”. Afërsia e kryerjes së këtyre veprimeve, nga shitja e apartamentit në emër të së motrës dhe bashkëshortit të saj, si dhe veprimet bankare për transferimin e shumës në dollarë, shumë e cila përkon afërsisht me çmimin e shitjes së apartamentit, të krijojnë bindjen se pagesa nga shitja e apartamentit është transferuar te shitësi P.B. Pas kësaj transferte, nuk ka veprime të tjera derisa kjo llogari është mbyllur në vitin 2004.

Sa më sipër, Kolegji vlerëson se shkak i mësipërm i ankimit, ngritur nga subjekti i rivlerësimit, nuk është bindës, pasi nuk mbështetet nga faktet dhe bie ndesh me provat.

Lidhur me pasurinë “apartament banimi, me sipërfaqe 70 m², me nr. pasurie {}, regjistruar me certifikatën për vërtetim pronësie të lëshuar më datë 27.03.2005, e ndodhur në lagjen nr. {***}, rr. “{***}”, Korçë”, në bashkëpronësi të subjektit me prindërit, shitur me kontratën nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 04.04.2005, në vlerën 1950.000 lekë, Kolegji konstaton si më poshtë.***

63. Sipas subjektit të rivlerësimit, vendimi i Komisionit është në kundërshtim me provat e administruara. Në ankim subjekti thekson se objekt i verifikimit në Komision është deklarata *vetting* dhe, për këtë arsye, vlerësimi për deklarim të rremë është tërësisht i pabazuar. Subjekti i rivlerësimit e ka shpjeguar se diferenca prej 1.150.000 lekësh midis deklaramit të vlerës së shitjes në vitin 2005 (3.100.000 lekë) dhe kontratës së shitjes (me vlerë 1950.000 lekë) vjen si pasojë e shtimit të vlerës së përfutur nga shitja e sendeve të luajtshme të banesës dhe nga mungesa e rregullimit ligjor për udhëzimin e plotësimit të deklaratës së pasurisë.

63.1 Kolegji konstatoi se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në DIPP-në e vitit 2005 se apartamenti në bashkëpronësi me prindërit është shitur në vlerën 3.100.000 lekë. Në kontratën e shitjes së sipërcituar, çmimi i apartamentit rezulton 1950.000 lekë. Në deklaratën *vetting*, subjekti ka deklaruar të ardhura nga ky apartament në vlerën 1.000.000 lekë, pasi kishte 1/3 pjesë takuese. Komisioni ka konkluduar se pjesa takuese e subjektit është 650.000 lekë, duke iu referuar çmimit të kontratës së shitjes.

63.2 Në analizë të sa më sipër, edhe të shpjegimit të subjektit të rivlerësimit, znj. Entela Prifti, në lidhje me diferencat e çmimit që sipas saj kanë ardhur si pasojë e shitjes së sendeve të luajtshme të banesës dhe nga mungesa e udhëzimit për plotësimin e deklaratës së pasurisë, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar gjithashtu se nuk ka deklaruar në kohë reale të ardhurat nga shitja e sendeve të banesës. Kolegji vlerëson se për të qenë e saktë në deklarim, nuk do të ishte nevoja për udhëzim, pasi duke qenë subjekt deklarimi e kishte detyrim ligjor deklarimin e shitjes së sendeve të banesës në kohë reale dhe se nga deklarimi nuk ka asnjë të dhënë që të hedhë dritë mbi këtë pretendim të subjektit. Për shitjen e sendeve të banesës, nuk rezulton asnjë faturë apo mandatpagesë për të provuar shitjen dhe çmimin e pretenduar nga subjekti i rivlerësimit. Nga ana tjetër, duke analizuar vlerën e banesës sipas kontratës (1950.000 lekë), është i dyshimtë fakti që vlera e sendeve të luajtshme, sipas deklaramit të subjektit (1.150.000 lekë), të jetë më e madhe se gjysma e vlerës së shtëpisë dhe ky fakt të mos pasqyrohet në kontratë. *Sa më sipër, shkak i pretenduar nga subjekti nuk është bindës dhe i bazuar në prova.*

64. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit pretendon se përfitimi i vlerës nga shitja e këtij apartamenti nga ana e subjektit, është deklaruar në DIPP-në e vitit 2005 dhe në deklaratën *vetting*, saktësisht 1.000.000 lekë, shumë e cila është e mjaftueshme për të mbuluar vlerën e marrë hua nga prindërit para shitjes së kësaj pasurie. Nga Komisioni, po ashtu edhe nga ILDKPKI-ja, nuk është marrë parasysh një akt i përpiluar me shkrim dore ndërmjet subjektit dhe prindërve të saj, sipas të cilit subjekti nuk do të përfitonte shumë tjetër, sado që të ishte vlera e shitjes, përveç shumës së huas.

64.1 Kolegji vlerëson se nuk përjashtohet mundësia që vlera e shitjes e kontraktuar të mos jetë reale, pasi kjo vlerë është një prag i përdorur për t'iu shmangur tatimit mbi çmimin e shitjes, që për vitin 2005 minimumi i vlerës së tatimit ishte 0,5% e çmimit të shitjes për vlerat 0-2.000.000 lekë, tatim i cili rritej përtej kësaj vlere shitjeje. Si rrjedhojë, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë me dokumentacion ligjor diferencën prej 1.150.000 lekësh, mes çmimit sipas kontratës së shitjes (1.950.000 lekë) dhe çmimit të deklaruar në deklaratën *vetting* (3.100.000 lekë).

Sa më sipër, shkaku i pretenduar nga subjekti nuk është i bazuar në prova.

Lidhur me shitjen e automjetit, tip “Renault”, me kontratën e shitjes nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 10.09.2004, në vlerën prej 450.000 lekësh, prodhim i vitit 1993, të cilën e ka blerë me kontratën nr. {***} rep., dhe {***} kol., datë 02.02.2002, me çmimin 500 USD, si dhe **shitjen e automjetit, tip “Benz DaimlerChrysler”,** blerë nga subjekti i rivlerësimit, znj. Entela Prifti, në vitin 2007, me kontratë shitblerjeje nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 18.08.2007, prodhim i vitit 2001, me vlerë 500.000 lekë, dhe shitur mbas dy vjetësh, në vitin 2009, me kontratën e shitblerjes nr. {***} rep., nr. {***} kol., në vlerën 6.000 euro, Kolegji konstatoi si më poshtë.

65. Lidhur me të ardhurat e krijuara nga shitja e automjeteve të mësipërme, subjekti i rivlerësimit, znj. Entela Prifti, pretendon se gjatë shqyrtimit në Komision të të ardhurave nga automjetet e saj, ka shpjeguar se makinat janë blerë në gjendje jashtë kushteve teknike dhe, për shkak të investimeve në aksesorë, në momentin e shitjes prej saj kanë qenë në gjendje më të mirë se në momentin e blerjes. Çmimi i shitjes nuk ka qenë më i lartë se çmimi i tregut. Subjekti i rivlerësimit konkludon për këtë pasuri se nuk ka kryer deklaram të rremë dhe nuk ka fshehur vlerën reale të shitjes së automjeteve, duke mos shkelur në këtë mënyrë asnjë ligj, siç pretendohet nga Komisioni.

65.1 Me kontratën e shitblerjes së cituar më sipër, subjekti i rivlerësimit ka blerë automjetin e tipit “DaimlerChrysler”, me vlerën 500.000 lekë dhe pas dy vitesh, këtë automjet e ka shitur me vlerë 6000 euro, pra me diferencë pozitive nga blerja në shitje. E njëjta gjë konstatohet edhe me automjetin tjetër, sipas kontratës së cituar më sipër, sipas së cilës automjeti “Renault” është blerë në vlerën 500 USD dhe është shitur pas dy vitesh e gjysmë në vlerën 450.000 lekë. Subjekti i rivlerësimit nuk provoi me dokumentacion ligjor punimet e përmirësimit të gjendjes teknike të makinave, siç pretendon, punime të cilat kanë përmirësuar gjendjen e tyre dhe, për rrjedhojë, janë shitur më shtrenjtë duke realizuar dhe fitim.

65.2 Subjekti sqaron se, për sa i përket diferencës midis çmimit të shitjes dhe atij të blerjes së këtyre automjeteve, në të dyja rastet makinat i ka blerë në gjendje teknike jashtë përdorimi. Pas blerjes, babai i subjektit që ka ushtruar për rreth 45 vjet profesionin e shoferit dhe mekanikut, ka punuar për riparimin e tyre nëpërmjet ndërrimit të pjesëve të prishura, kryerjes së riparimeve teknike dhe kthimin e tyre në gjendje pune (shpjegimet e subjektit pas rezultateve të hetimit). Në momentin e shitjes së tyre, makinat kanë qenë në gjendje teknike shumë të mirë dhe të rregullta për qarkullim.

65.3 Kolegjit, pas shqyrtimit të akteve të administruara në Komision për këtë shkak, i rezultoi se kur subjekti i rivlerësimit ka blerë mjetin me kontratën nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 18.08.2007, sipas saj [kontratës] ka pranuar faktin se blerësi [subjekti i rivlerësimit] nuk ka asnjë lloj pretendimi për gjendjen teknike të këtij mjeti. Një automjet në gjendje teknike jashtë përdorimi është i destinuar për t'u çregjistruar dhe jo për t'u blerë relativisht shtrenjtë dhe të për t'u shitur pas dy vitesh me çmim edhe më të lartë. Pavarësisht se palët janë të lira të përcaktojnë çmimet e shitjes dhe pavarësisht se nuk ka çmime reference për shitblerje automjetesh, vlerat e blerjes së këtyre automjeteve janë jashtë logjikës sipas së cilës një mjet që përdoret, amortizohet.

65.4 Nga ana tjetër, Kolegji vëren se subjekti i rivlerësimit ka realizuar fitim prej këtyre transaksioneve, në vlerësim të parashikimeve të nenit 8, pika 1, germa “g” e ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 8438/1998”), i cili përcakton se: *Për qëllime të tatimit mbi të ardhurat personale merren si të ardhura të tatueshme të ardhura të tjera që nuk identifikohen në format e paraqitura në këtë nen, të realizuara nga individë rezidentë, ose nga persona jorezidentë, por me burim në Republikën e Shqipërisë.* Nën dritën e sa më sipër, të ardhurat e realizuara nga shitja me fitim e pasurive të luajtshme nuk bëjnë pjesë në të ardhurat e përjashtuara nga neni 8/1 i të njëjtit ligj. Për vlerën e fitimit të realizuar nga shitja e automjeteve (diferenca mes çmimit të shitjes dhe çmimit të blerjes së automjetit), nuk u provua pagimi i detyrimit tatimor mbi këtë fitim. Për rrjedhojë, vlera e fitimit të realizuar rezulton të jetë e ardhur e paligjshme, në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016.

Shkaku i mësipërm i ngritur nga subjekti i rivlerësimit në ankim, nuk është i bazuar.

Lidhur me pasurinë “apartament banimi dubleks, me sipërfaqe 235 m², me nr. pasurie {}, ndodhur në rr. “{***}”, Korçë”, fituar me kontratën e shitjes, nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., dhe nr. {***} rep., dhe kontratën nr. {***} kol., datë 15.04.2004, e blerë si ndërtim i papërfunduar karabina me vlerë 2.000.000 lekë në total, me investim personal për përfundimin e rifiniturave me firmë tjetër ndërtimi, në shumën 1.316.300 lekë dhe mobilim me blerje pajisjesh dhe mobiliesh për pjesën tjetër të vlerës, prej 2.000.000 lekësh, Kolegji konstatoi si më poshtë.***

66. Subjekti i rivlerësimit pretendon se përfundimi i Komisionit se subjekti ka bërë deklaram të rremë në lidhje me investimin personal për përfundimin e rifiniturave në vlerën 1.316.300 lekë, nuk është i bazuar në dokumente provuese. Subjekti ka sjellë preventivin e punimeve, të cilin e ka pranuar edhe firma e ndërtimit që i ka bërë këto ndërtime, por që nuk mund ta gjejë në

arkivat e saj këtë dokument dhe këtë kontratë, për shkak të kohës së largët prej 17 vitesh, si dhe për shkak të vjedhjes së arkivave të firmës disa herë.

66.1 Kolegji konstaton se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka lidhur një kontratë paraprake shitblerjeje me nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., në të cilën përcaktohet se shitësi do t'i dorëzojë blerësit apartamentin pas përfundimit të ndërtimit dhe se çmimi i blerjes së apartamentit prej 2.000.000 lekësh është paguar jashtë zyrës noteriale, fakt i cili nuk është pasqyruar në deklaratën para fillimit të detyrës të vitit 2003 nga subjekti i rivlerësimit, znj. Entela Prifti, dhe as nga bashkëshorti i saj. Është deklaruar në DIPP-në e vitit 2004, ndërsa në deklaratën *vetting* bashkëshorti i subjektit ka deklaruar kontratat e shitblerjes, si edhe situacionin prej 1.316.300 lekësh, me burime krijimi: kredi të marrë në Fefad Bank dhe kursime të të ardhurave nga paga.

66.2 Lidhur me investimin e kryer për përfundimin e rifiniturave në vlerën 1.316.000 lekë, situacioni i punimeve nga firma “{***}”, Kolegji konstaton se ky situacion nuk ka as datën dhe as periudhën kur janë realizuar punimet, si dhe mungon dokumentacioni ligjor (pranuar edhe nga subjekti), duke përfshirë këtu mandatpagese, faturë tatimore e shoqërisë, konfirmë bankare për likuidimin e shumës 1.316.000 lekë, pranë kësaj shoqërie. Meqenëse situacioni i punimeve nuk përmban elementet formale dhe thelbësore të nevojshme për të përcaktuar periudhën të cilës i përket, si dhe në kushtet e mungesës së shoqërimit të këtij situacioni me faturë tatimore ose konfirmim bankar për kalimin e kësaj shume firmës së mësipërme të ndërtimit, nuk u provua që investimi i deklaruar është sipas situacionit të paraqitur nga subjekti i rivlerësimit. Për më tepër, ky situacion nuk ka vlerë provuese qoftë për shkak të elementeve të formës, qoftë për shkak të mosmbështetjes në dokumentacion shtesë.

Kolegji vlerëson se edhe pretendimi i mësipërm i ankueses nuk qëndron.

- 67.** Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit pretendon në ankim se pasuria e blerë ishte në gjendjen e karabinasë dhe e kishte të nevojshme përshtatjen për banim, duke kryer punime sipas situacionit në vlerën e cituar në paragrafin më sipër. Komisioni është në kundërshtim me ligjin kur vlerëson se çmimi, sipas kontratave të shitjes cituar më sipër (2.000.000 lekë), nuk është real dhe konstaton se është fshehur çmimi real i pasurisë së blerë, duke iu referuar kostove mesatare të ndërtimit të përcaktuara nga Enti Kombëtar i Banesave (në vijim “EKB”), të cilat janë referuese dhe të destinuara për ndërtime të kryera nga firma ndërtimi për objekte sociale, ndaj nuk mund të merren *apriori* nga kushdo.

67.1 Në analizën e Kolegjit, konstatohet se megjithëse objekt i veprimtarisë së EKB-së është financimi, ndërtimi dhe shitja e banesave në kushtet e konkurrencës së lirë, për mbështetjen e politikave sociale të strehimit dhe për sigurimin e banesave me kosto të ulët, ky institucion zbaton vendimet e Këshillit të Ministrave dhe udhëzimet përkatëse, të cilat miratojnë kostot mesatare të ndërtimit/shfrytëzimit, si dhe vlerat mesatare të apartamenteve në tregun e lirë të banesave në shkallë qarku, për vitet specifike. Ndaj vlerat e kostos së ndërtimit, të zbatuara nga EKB-ja, janë në nivele edhe më të ulëta se vlerat mesatare të përcaktuara për tregun e lirë të banesave.

67.2 Duke iu referuar udhëzimit me nr. 5, datë 31.05.2001, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga EKB, të vlerave të tregut të lirë të banesave dhe koeficientit K”, përcaktohet vlera e kostos mesatare të ndërtimit për vitin 2001, që është 25291 lekë/m², ndërsa për sipërfaqe shfrytëzimi është 30867 lekë/m². Këto vlera po të shumëzohen me metrat katrorë të sipërfaqes së apartamentit (25291 L/m² x 235 m²), rezulton çmimi 5.943.385 lekë, vlerë në kosto ndërtimi, ndërsa për kosto shfrytëzimi (30867 L/m² x 235 m²) rezulton çmimi 7.253.745 lekë.

67.3 Sa më sipër, rezulton se kostoja e ndërtimit të apartamentit, sipas standardeve udhëzuese të marra nga EKB-ja për vitin 2001, është më e lartë se çmimi që ka deklaruar subjekti i rivlerësimit për blerjen e karabinasë dhe kryerjen e rifiniturave. Në këto kushte, çmohet i drejtë konkluzioni i Komisionit se çmimi i parashikuar në kontratë dhe i deklaruar nga subjekti duket si çmim joreal, duke qenë se është nën koston e ndërtimit dhe të shfrytëzimit, si dhe tregut të lirë për vitin 2001⁷. *Kolegji vlerëson se shpjegimi i subjektit të rivlerësimit për sa më sipër, nuk është bindës dhe, për pasojë, shkak i ankimit nuk është objektiv dhe i bazuar.*

68. Subjekti i rivlerësimit pretendon se vendimi i Komisionit në lidhje me pamjaftueshmëritë e burimeve të ligjshme për krijimin e kësaj pasurie është tërësisht i kundërligjshëm, duke mos marrë parasysh prova dhe duke përlloritur në mënyrë të gabuar të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit për vitet kur është krijuar kjo pasuri. Subjekti i rivlerësimit, znj. Entela Prifti, pretendon se Komisioni ka bërë një gabim duke mos përlloritur të ardhurat e saj dhe të bashkëshortit që nga viti 1985 deri në vitin 2000, edhe pse subjekti i ka sjellë edhe akte provuese.

68.1 Kolegji vlerësoi se nga analiza financiare e kryer, duke përfshirë informacionin që gjendet në dosjen e ardhur nga Komisioni, janë përlloritur të ardhurat nga puna e subjektit të rivlerësimit për vitet 1995-2004, sipas vërtetimeve të pagave të sjella nga institucionet përkatëse. Në këto të ardhura nuk u përlloritur paga para vitit 1995, pasi kishte mungesë dokumentacioni nga institucionet zyrtare, ndërsa bashkëshortit të subjektit iu përlloritur periudha 1985-2000. Në këtë rast, edhe sikur të kryenim përlloritje për dy vjet paga të viteve 1993 dhe 1994 të subjektit, diferenca nuk do të ndryshonte në pozitive, për shkak të diferencës së madhe negative të përlloritur me të gjitha mënyrat.

68.2 Nga analiza e Kolegjit, rezultoi se për periudhën 1985-2004, të ardhurat e subjektit të rivlerësimit, znj. Entela Prifti, dhe të bashkëshortit të saj kanë qenë në vlerën 8.078.538,2 lekë nga paga dhe 450.000 lekë nga shitja e një autoveture në pronësi të subjektit të rivlerësimit. Subjekti i rivlerësimit, znj. Entela Prifti, dhe bashkëshorti i saj kanë investuar në pasurinë “apartament dubleks, me sipërfaqe 235 m²” në vlerën 4.000.000 lekë, në shtimin e likuiditeteve në llogaritë bankare në vlerën 3.061.948,79 lekë, në blerjen e një toke arë në vlerën 576.667 lekë, si dhe në blerjen e aksioneve në shoqërinë “{***}” në vlerën 6.256.000 lekë. Për të mundësuar blerjen e disa prej këtyre pasurive, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar disa huamarrje nga z. V.P. (babi i subjektit) në vlerën 1.000.000 lekë, nga z. A.B. në vlerën 5.000.000 lekë dhe një kredi bankare në vlerën 2.445.934 lekë. Gjatë kësaj periudhe, subjekti i rivlerësimit,

⁷ Vendimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelit nr. 10/2019(JR), paragrafi 51.1.

znj. Entela Prifti, dhe bashkëshorti i saj kanë kryer transfertën bankare në {***}, Shtetet e Bashkuara të Amerikës, në vlerën 1.739.659 lekë, kanë paguar këste kredie në vlerën 1.420.000 lekë dhe kanë paguar qira banese në vlerën 144.000 lekë. Nga kjo analizë, edhe nëse do të konsideronim se huamarrësit kanë pasur mundësi t'i jepnin subjektit dhe bashkëshortit të saj vlerat e mësipërme dhe të konsideronim si të ligjshme të ardhurën e përfituar nga shitja e makinës, totali i të ardhurave 16.974.472,2 lekë (8.078.538,2 lekë + 450.000 lekë + 5.000.000 lekë + 2.445.934 lekë + 1.000.000 lekë + 6.000.000 lekë) nuk do të ishte i mjaftueshëm as për blerjen e pasurive të mësipërme dhe përbalimin e shpenzimeve të sipërcituara në vlerën 17.198.274,79 lekë (4.000.000 lekë + 3.061.948,79 lekë + 576.667 lekë + 1.739.659 lekë + 1.420.000 lekë + 144.000 lekë), pa llogaritur këtu shpenzimet e nevojshme për jetesë. Nga sa më sipër, subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj, edhe nëse përllogarisim të ardhurat nga viti 1985 deri në 2004, nuk mbulon me të ardhura të ligjshme krijimin e pasurive, kursimeve dhe shpenzimeve deri në vitin 2004.

Sa më sipër, pretendimi i subjektit nuk është i bazuar në ligj e në prova.

69. Subjekti i rivlerësimit, nëpërmjet ankimit, ngre pretendimin se pasuria në formën e likuiditetit në shumën prej 2.893.050 lekësh, nuk ka qenë e ardhur gjendje në bankë e subjektit të rivlerësimit, por ka qenë shumë e hedhur gabim në llogarinë personale të bashkëshortit të subjektit, në vend që të hidhej në llogarinë e Ujësjiellës Kanalizime Korçë dhe më pas e sistemuar nga banka. Në përfundim të këtij shkaku ankimi, subjekti përmbledh se në analizë të të ardhurave të realizuara nga momenti i fillimit të marrëdhënieve të punës, për subjektin dhe bashkëshortin e saj deri në vitin 2004 justifikohen plotësisht investimet e kryera dhe shpenzimet familjare.

69.1 Nga verifikimet e llogarisë së bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, rezulton se kjo llogari është kredituar katër herë në vlerën totale prej 2.893.050 lekësh, për katër muaj rresht, në vitin 2004. Këto vlera kanë qëndruar në llogarinë e bashkëshortit të subjektit deri në muajin maj të vitit 2005, duke kapitalizuar interesa. Saktësisht, në datën 04.05.2005, llogaria e bashkëshortit të subjektit është debituar në vlerën 2.893.050 lekë, me përshkrimin: *hedhur gab. në llog. pers. çek {***};{***};{***};{***};{***}*. Në datën 31.12.2004, për shumën në gjendjen e llogarisë së tij, të përbërë pikërisht nga këto shuma, ka përfituar interesa në shumën 18.930 lekë. Kjo vlerë nuk është debituar nga llogaria e bashkëshortit të subjektit, së bashku me shumën 2.893.050 lekë, në muajin maj të vitit 2005, por ka qenë gjendje në këtë llogari deri në vitin 2007, kur llogaria është mbyllur. Në dosjen dhe aktet e ardhura nga Komisioni, nuk gjendet asnjë dokument që të provohet “sistemimi” i llogarisë së UKKO nga llogaria e subjektit, si rrjedhojë nuk u provua pretendimi i subjektit të rivlerësimit, znj. Entela Prifti, që shuma e sipërcituar është hedhur gabimisht në llogarinë e bashkëshortit të saj nga UKKO, pasi nuk rezulton i provuar sistemimi i mëtejshëm i kësaj shume.

Sa më sipër, shkaku i ngritur nga subjekti nuk është i bazuar.

Lidhur me pasurinë “banesë me sipërfaqe 198 m², “{}”, me nr. pasurie {***}, regjistruar me certifikatën e pronësisë me nr. {***}, datë 17.04.2009, lëshuar nga ZRPP Korçë, ndodhur në {***}, Korçë, nr. {***}”, vlera 4.000.000 lekë, pronësia është fituar me dy veprime juridike, të cilat konfirmohen me shkresën e ZVRPP-së Korçë: a) kontratë dhurimi nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 20.06.2008, për fitimin e pronësisë mbi ½ pjesë të pronës; b)***

*kontratë shitblerjeje me nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 19.03.2009, për fitimin e pronësisë mbi ½ pjesë të pronës në vlerën 4.000.000 lekë.*

70. Subjekti i rivlerësimit pretendon se deklarimi për këtë pasuri është bërë sipas dokumentacionit të ZRPP-së, në lidhje me sipërfaqen e banesës. Në analizë të rrethanave të mësipërme, rezulton se deklarimi i pasurisë “banesë”, e ndodhur në Korçë, në {***}, me sipërfaqe trualli 198 m² dhe sipërfaqe ndërtimi 133 m², duhet të konsiderohet i saktë, në përputhje me ligjin dhe aktet nënligjore në fuqi, konkretisht udhëzimin e ILDKPKI-së për mënyrën e plotësimit të deklaratës *vetting*.

70.1 Në analizë të shkakut të sipërcituar të ankimit, Kolegji vëren se në certifikatën e pronësisë me nr. {***}, datë 17.04.2009, lëshuar nga ZRPP Korçë, në emër të z. P.T., bashkëshortit të subjektit, rezulton i përshkruar lloji i pasurisë truall, me sipërfaqe 198 m², nga kjo 133,56 m² ndërtesë. Rezulton se në praktikën e ZRPP-ve bëhet regjistrimi i sipërfaqes reale të truallit, ndërsa për sipërfaqet ndërtimore shënohen vetëm metrat katrorë të gjurmës së ndërtimit. Përshkrimi i detajuar për katet e ndërtimit bëhet në kartelën e pasurisë, që në këtë rast nuk është bërë as në kartelën përkatëse. Gjithsesi, subjekti i rivlerësimit, znj. Entela Prifti, dhe personi i lidhur, bashkëshorti i saj, bazuar në nenin 33, pika 5, germa “a” e ligjit nr. 84/2016, në kuadër të saktësisë së deklaratimit dhe në përputhje me ligjin, kishin detyrimin të deklaronin sipërfaqen totale të shfrytëzimit të banesës, edhe pse në dokumentacion rezulton e shënuar vetëm gjurma ndërtimore.

Sa më sipër, shkakun e pretenduar nga subjekti nuk është i bazuar.

71. Në lidhje me përfitimin e pronësisë së banesës për fitimin e ½ pjesë takuese me kontratë dhurimi, subjekti i rivlerësimit pretendon se përfundimet e Komisionit janë tërësisht në kundërshtim me ligjin nr. 84/2016, legjislacionin material e procedural që rregullon marrëdhëniet e kontratës së qirasë dhe vlerën e provave shkresore e, në këto rrethana, edhe për këtë pjesë vendimi duhet të ndryshohet. Lidhur me vlerësimin e deklaratës me shkrim dore si e pavlefshme të administratores së pronës, Komisioni ka mbajtur qëndrime subjektive. Referuar dispozitave, si nenet 246 dhe 258 të Kodit të Procedurës Civile, Komisioni nuk ka mundur të provojë asnjë element të pavlefshmërisë së saj.

71.1 Kolegji konstaton se Komisioni ka vlerësuar, ashtu siç rezulton edhe nga dokumentacioni në dosje, se pasuria e paluajtshme e sipërcituar, e regjistruar në emër të z. P.T., e llojit truall + ndërtesë, nga kjo 198 m² truall dhe 133,56 m² ndërtesë, është përfituar ½ me kontratë shitblerjeje me nr. {***} rep., dhe {***} kol., datë 19.03.2009, si dhe ½ me anë të kontratës së dhurimit me nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 20.06.2008. Komisioni ka konkluduar në lidhje me dhurimin se personi i lidhur me subjektin e rivlerësimit ka bërë deklaram të rremë për dhurimin e ½ ndërtesë dhe ka nënshkruar një kontratë fiktive për shkak se subjekti i rivlerësimit nuk shpjegoi bindshëm me dokumentacion justifikues ligjor shkakun e ligjshëm që e ka shtyrë mikun e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit për të bërë këtë dhurim të ½ pjesë të kësaj godine, e cila rezultoi fitimprurëse për personin e lidhur. Personi tjetër i lidhur, z. B.K., nuk dërgoi dokumentacion ligjor provues për të justifikuar burimin e ligjshëm të krijimit të këtij dhurimi, sipas nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016.

71.2 Gjithashtu, nga vlerësimi i Kolegjit, rezultoi se lidhur me dhurimin e ½ ndërtesë nga z. B.K. te z. P.T. (bashkëshorti i subjektit), ky i fundit ka deklaruar në deklaratën *vetting* se dhurimi ka ardhur si pasojë e marrëdhënieve familjare miqësore dhe një investimi të kryer për rikonstrukcionin e saj në vitet 2000-2001, pasi ka jetuar deri në vitin 2004 familjarisht në këtë banesë me kontratë qiraje. Ky pretendim i subjektit të rivlerësimit nuk është bindës dhe nuk është i mbështetur në prova. Nga njëra anë subjekti i rivlerësimit, znj. Entela Prifti, dhe bashkëshorti i saj kanë paguar 10.000 lekë qira për të banuar në këtë ndërtesë, sipas një deklarate me shkrim dore të nënshkruar nga znj. A.K. (bashkëshortja e dhuruesit B.K.), nga ana tjetër kjo e fundit i njihte shpenzimet për rikonstrukcion banese subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortit të saj, madje për këtë fakt i kishte vënë vetes (A.K.) afat 2-vjeçar për shlyerjen e këtyre shpenzimeve, në të kundërt z. P.T. do të kompensohej me ndërtesën për të cilën i paguante qira znj. A.K.

71.3 Përveç deklaratës nga znj. A.K., personi i lidhur nuk kishte paraqitur ndonjë dokument bashkëlidhur për të provuar shumën e investuar në rikonstrukcionin e godinës ku jetonin me qira, me qëllim vërtetimin e shpenzimeve të kryera sipas kësaj deklarate. Si rrjedhojë, detyrimi që administratorja ka vendosur për kryerjen e shpenzimeve nga qiradhënësi bie ndesh me faktin e detyrimit të pagesës mujore për qiranë nga qiradhënësi, pasi momentalisht për shpenzimet e investuara në përshtatjen e ambienteve të banimit nga qiradhënësi, palët bien dakord që të zbriten ose qiradhënësi nuk ka detyrimin t'i njohë kur ato merren përsipër të kryhen në mënyrë të njëanshme nga qiramarrësi. Nga ana tjetër, znj. A.K. ishte bashkëshortja e z. B.K., të cilit iu dhurua ½ e ndërtesës në vitin 2007. Në deklaratën me shkrim dore të nënshkruar nga vetë ajo (znj. A.K.) në datën 10.10.2000, rezulton si administratore e katit të parë, në një kohë që ndërtesa ishte në pronësi të familjes Z., që nga data 17.09.1993, kthyer me vendimin nr. 43 të Komisionit të Kthimit dhe Kompensimit të pronave të ish-pronarëve të Bashkisë Korçë. Si rrjedhojë, znj. A.K. nuk legjitimohet të krijojë marrëdhënie juridike në lidhje me pronën, aq më tepër të kushtëzuar deri në dhurimin e saj në rast mospërmbushjeje nga ana e saj të shpenzimeve të kryera nga qiramarrësi.

71.4 Kolegji vlerësoi se subjekti i rivlerësimit nuk shpjegoi bindshëm me dokumentacion ligjor shkakun e ligjshëm që e ka shtyrë mikun e tij t'i bëjë këtë dhurim të ½ pjesë të kësaj godine, e cila më tej rezultoi shumë fitimprurëse për personin e lidhur. Si rrjedhojë, nga tërësia e rrethanave dhe fakteve lidhur me këtë shkak, si dhe nga dokumentacioni i vënë në dispozicion nga subjekti, Kolegji krijoi bindjen se nëpërmjet kontratës së dhurimit, subjekti nuk ka treguar vlerën reale të fitimit të kësaj pasurie, si pasojë as burimin e krijimit të saj.

Sa më sipër, shkaku i pretenduar nga subjekti nuk është i bazuar në ligj.

72. Subjekti i rivlerësimit pretendon se sa i përket konkluzionit të Komisionit se subjekti nuk ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të blerjes së ½ pjesë të godinës në shumën 4.000.000 lekë, ky i fundit pretendon se të gjitha burimet e përdorura për këtë blerje janë të ligjshme. Subjekti i rivlerësimit sqaron se ka dhënë shpjegimet e nevojshme për secilën nga këto burime, të ardhura nga kursimet nga pagat, shitja e makinës 6000 euro, si dhe bonot e thesarit të prindërve të bashkëshortit deri në vitin 2008.

72.1 Për sa u përket investimeve në bono thesari, nga gjenda e llogarive të z. B.T. dhe znj. F.T. në Bankën e Shqipërisë, rezulton se: në vitin 2004, z. B.T. ka investuar në bono thesari vlerën 300.000 lekë dhe e ka rritur vlerën e investimit vit pas viti deri në vitin 2008, në vlerën 1.000.000 lekë. Znj. F.T. ka investuar në bono thesari në vitin 2002 vlerën 900.000 lekë dhe e ka rritur vlerën e investimit vit pas viti deri në vitin 2008, në vlerën 1.000.000 lekë. Subjekti i rivlerësimit, znj. Entela Prifti, në pretendimet e saj ka përmendur se prindërit e bashkëshortit kanë pasur paga relativisht të larta gjatë punësimit të tyre dhe të ardhurat e përfituara nga pensioni vit pas viti.

72.2 Nga dokumentacioni i administruar në Komision, rezulton se prindërit e bashkëshortit të subjektit kanë dalë në pension respektivisht në vitin 1984 dhe në vitin 1991, babai dhe nëna. Investimet në bono thesari janë kryer nga viti 2002, 13 dhe 18 vjet më pas. Të ardhurat nga pensioni i babait të bashkëshortit, nga viti i daljes në pension deri në vitin 2004 kur është kryer investimi në bono thesari, ka qenë në vlerën 736.840 lekë. Të ardhurat nga pensioni i nënës të bashkëshortit, që nga momenti i daljes në pension deri në vitin 2002, kur është investuar në bono thesari, ka qenë në vlerën 509.668 lekë.

72.3 Kolegji vlerësoi se nga analiza e kryer, në bazë të dokumentacionit të administruar në dosjen e Komisionit, rezulton se të ardhurat e prindërve të personit të lidhur të subjektit të rivlerësimit, për këto vite, nuk do të mjaftonin për të investuar në bono thesari në vlerën 300.000 lekë babai i bashkëshortit në vitin 2003 dhe 900.000 lekë nëna e bashkëshortit në vitin 2002.

72.4 Për sa i përket aktivitetit të këmbimit valutor të ushtruar nga babai i bashkëshortit, nuk rezulton e provuar me ndonjë akt në dosje ligjshmëria e të ardhurave nga puna në këtë aktivitet. Për sa u përket të ardhurave nga qiradhënia e shtëpisë së motrës së bashkëshortit të subjektit, nuk rezulton e provuar marrëdhënia e qirasë dhe aq më tepër pagimi i detyrimeve tatimore për të ardhurat e pretenduara të përfituara nga kjo marrëdhënie. Për sa u përket të ardhurave nga shitja e banesës së motrës së bashkëshortit të subjektit, nuk provohet e dokumentuar me asnjë mjet tjetër procedural se kjo shumë u ka kaluar prindërve të bashkëshortit.

Sa më sipër, shkak i pretenduar nga subjekti nuk është i bazuar.

- 73.** Subjekti i rivlerësimit, nëpërmjet ankimit, pretendon se Komisioni krahason një ndërtim tejet të amortizuar të viteve 1930 me një pronë të ndryshuar dhe të investuar nga subjekti në ditët e sotme. Sipas subjektit, Komisioni nuk mund ta kryejë këtë vlerësim në bazë të çmimit të Entit të Banesave, por ai duhet të kryhet nga ekspertë vlerësues për ushtrimin e këtij aktiviteti, si: bankat, ZVRPP, gjykata, prokuroria e mjaft të tjera. Kontrata është lidhur nga dy palët dhe ka fuqinë e ligjit për palët, sipas neneve 690 dhe 691 të Kodit Civil.

73.1 Kolegji konstaton se nga shqyrtimi i akteve të administruara, nuk rezulton që Komisioni ka përlllogaritur vlerën e godinës me çmimin e referencës së ndërtimeve, nga EKB-ja në këtë rast. Në kartelën e pasurisë, lëshuar bashkë me certifikatën e pronësisë, sipas regjistrimit të datës 17.04.2009, rezulton që shuma e paguar nga z. P.T. në blerjen e ½ së banesës, është 4.000.000 lekë. Një vit më parë, ky i fundit ka bërë regjistrimin e pasurisë më datë 17.07.2008, së dhuruar nga z. B.K., nga i cili për ½ pjesë të banesës rezulton çmim reference në vlerën 4.140.177 lekë. Vetë subjekti i rivlerësimit ka pohuar që banesa është blerë në kushte nevojë të

shitësit, duke respektuar të drejtën e parablerjes së bashkëpronarit. Meqenëse ndërtesa ndodhet në qendër të qytetit të Korçës, ka vlera kulturore e historike dhe është burim i konsiderueshëm të ardhurash, vlera e blerjes nuk justifikohet me çmimin e referencës. Në analizë të sa më sipër, nga dokumentacioni në dosje, si dhe nga deklaratimet e subjektit nuk krijohet bindja që çmimi i blerjes së ½ së ndërtesës është real. Si rrjedhojë, subjekti duke mos deklaruar në kontratë çmimin real të blerjes së banesës, nuk tregon vlerën dhe, për rrjedhojë, burimin e krijimit të të ardhurave që i kanë shërbyer për blerjen e ½ të banesës.

Sa më sipër, shkak i pretenduar nga subjekti nuk është i bazuar.

74. Lidhur me vlerën e punimeve për rikonstrukcionin e godinës, subjekti pretendon në ankim se Komisioni nuk merr parasysh provat e sjella nga vetë subjekti, por hamendëson në nxjerrjen e konkluzioneve. Subjekti i rivlerësimit pretendon të ketë sjellë prova të cilat provojnë se pagesa është bërë *cash* ndaj firmës të ndërtimit, e ndarë në kohë në vitet 2011-2012, e marrë nga Banka Credins. Sipas subjektit të rivlerësimit, arsyeja se me pagesën e punimeve me para në dorë është fshehur vlera reale e investuar për rikonstrukcion, është jologjik.

74.1 Lidhur me këtë shkak ankimor, në dosje rezulton një situacion punimesh i shoqërisë së ndërtimit “{***}”, që i përket periudhës shkurt 2012, për godinën private në {***}, me kosto në shumën 6.979.400 lekë. Kjo vlerë, sipas subjektit, është shlyer nga bashkëshorti i saj me mandatarkëtimin nr. 36, datë 16.02.2012, me burim nga kredia e marrë në Bankën Credins në shumën 70.000 euro, nëpërmjet kontratës me nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 26.12.2011.

74.2 Në kontratën e kredisë së sipërcituar, në nenin 2 të saj “Objekti i kredisë”, është specifikuar shuma e aprovuar për kredi në vlerën 70.000 euro, si dhe qëllimi i kreditimit “Blerje shtëpie” e jo për rikonstrukcion banese. Më tej, në paragrafin 2.3 të këtij neni, specifikohet se është plotësuar i gjithë dokumentacioni i kërkuar nga kredimarrësi në formën dhe përmbajtjen e pranueshme nga banka, që në kushte normale subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti duhet të kishin paraqitur dokumentacion në funksion të qëllimit të kredisë, pra për blerje shtëpie, siç përcaktohet në nenin 2.3 të kontratës së kredisë, dhe jo për rikonstrukcion banese. Kontrata nuk ka të bashkëlidhur dokumentacionin shoqëruar të kreditimit.

74.3 Nga ana tjetër, mënyra e pagesës së situacionit të punimeve nuk është në formën e kërkuar nga ligji. Bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, znj. Entela Prifti, shumën e siguruar nga kredia bankare mund ta kalonte në llogarinë e shoqërisë ndërtimore dhe jo me pagesë *cash* pranë ambienteve të shoqërisë. Legjislacioni tatimor nuk njeh mandatarkëtimet si mënyrë pagese, por vetëm faturat tatimore me TVSh, që duhet t’i bashkëlidhen situacionit mujor të punimeve, sipas udhëzimit nr. 17, datë 13.05.2008, “Për tatimin mbi vlerën e shtuar në Republikën e Shqipërisë”. Personi i lidhur/bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit nuk provoi kryerjen e pagesës me një nga mënyrat ligjore, si transaksion bankar, pasi ai deklaronte se ajo është kryer me lekë në dorë (me mandatarkëtim), edhe pse shuma ishte e konsiderueshme. Fakti që subjekti kishte marrë kredi bankare për të shlyer vlerën e rikonstrukcionit, tregon se subjekti kishte mundësi reale për të bërë transferimin me bankë nga ai te shoqëria e ndërtimit. Për sa rezulton nga rrethanat, nuk u provua shuma e paguar, lloji i punimeve, si dhe koha e kryerjes së punimeve të rikonstrukcionit.

75. Në lidhje me konstatimin e problemeve të gjetura nga Komisioni për arredimin e godinës dhe kthimin në lokal shërbimi, subjekti i rivlerësimit pretendon se ka provuar me prova shkresore se investimi nuk është kryer as nga subjekti vetë dhe as nga bashkëshorti i saj, por nga qiramarrësi shoqëria “{***}”. Sipas subjektit të rivlerësimit, ky fakt provohet edhe nga aktmarrëveshja midis bashkëshortit të subjektit dhe shoqërisë “{***}”.

75.1 Kolegji vëren se në deklaratën *vetting* bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka deklaruar të ardhura nga kontrata e qirasë, datë 05.03.2012, me shoqërinë “{***}” për periudhën 2012-2013. Mes bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit dhe shoqërisë “{***}” është lidhur një kontratë qiraje më datë 05.03.2012, e cila nuk është hartuar para noterit, por vetëm me nënshkrimin e palëve, me vlerë të përcaktuar 3000 euro në muaj për një periudhë 2-vjeçare, e cila do të përdoret për qëllime tregtare. Pas lidhjes së kësaj kontrate, palët kanë lidhur aktmarrëveshjen më datë 14.01.2013, ku të njëjtat palë bien dakord që objektit të marrë me qira t’i ndryshohet destinacioni nga banesë në lokal shërbimi nga qiramarrësi dhe, për këtë qëllim, të mbahet në përdorim pa kundërshpërblim për periudhën prill-dhjetor 2013.

75.2 Subjekti i rivlerësimit nuk provoi saktë me dokumentacion vlerën e investimit të objektit të marrë me qira, të cilit i është ndryshuar destinacioni i përdorimit. Investimi për ta kthyer nga banesë në lokal, një objekt rreth 400 m², duhet të jetë relativisht i madh, që të besohet se është kryer nga qiramarrësi. Sipas nenit 817 të Kodit Civil, nëse qiramarrësi ka bërë shtesa në sendin e marrë me qira, ka të drejtë t’i heqë ato në mbarim të qirasë, kur kjo mund të kryhet pa dëmtuar sendin, përveç kur pronari pranon t’i mbajë vetë ato dhe kompenson qiramarrësin. Rezulton që qiramarrësi të ketë marrë përsipër një shpenzim të konsiderueshëm investimi në një ndërtesë të cilën e përfitoi pa qira vetëm për 9 (nëntë) muaj, që në kushtet e pagesës së qirasë barazohen me 27 mijë euro. Nuk rezulton e provuar se kujt i përkasin shpenzimet e kryera për ndryshimin e destinacionit, nga banim në përdorim për qëllim tregtar. Nga kontrata e qirasë e vitit 2013, del indirekt se për 9 muaj qiramarrësi nuk do paguajë qiranë, që duke e shumëzuar me vlerën mujore të qirasë (9 muaj x 3000 euro) rezulton shuma 27.000 euro, por nuk është specifikuar se këto janë investime të kryera nga ana e qiramarrësit. As në dosje nuk gjendet asnjë dokument që të provojë se të kujt janë investimet për ndryshimin e destinacionit të godinës.

75.3 Sa më sipër, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të shpjegojë bindshëm dhe të provojë vlerën e investuar për arredimin e godinës për ndryshimin e destinacionit, pasi nuk paraqiti dokumentacion justifikues ligjor në lidhje me këtë investim, për kthimin nga shtëpi banimi në njësi shërbimi, ndaj *shkaku i pretenduar nga subjekti nuk është i bazuar*.

76. Subjekti i rivlerësimit pretendon se për objektin verandë, Komisioni ka perceptuar gabim provat, pasi ky objekt nuk është përshtatur e ndërtuar në vitin 2012 nga subjekti i rivlerësimit, znj. Entela Prifti, dhe bashkëshorti i saj, por në vitin 2014 nga qiramarrësi, shoqëria “{***}”, me shpenzimet e saj. Për kryerjen e këtij ndërtimi, është miratuar leja përkatëse nga Bashkia Korçë, bashkë me projektin ndërtimor “Autorizim për kryerje punimesh mirëmbajtjeje, datë 10.11.2014”. Sipas subjektit, kjo shtesë është kryer nga qiramarrësi dhe nuk ka ndikuar as në shtimin dhe as në pakësimin e vlerës së ndërtimit, duke qenë se është provizore.

76.1 Kolegji vëren se subjekti i rivlerësimit në vitin 2012 ka ndërtuar një verandë, e cila nuk ka qenë pjesë e strukturës ekzistuese të godinës së banimit. Kur janë kryer punimet për rikonstrukcionin dhe kthimin e godinës në njësi shërbimi, kati i tretë është përshtatur si verandë, me qëllim që të përdorej për bar-kafe. Ndryshimi i këtij destinacioni shoqërohet me investime, nëpërmjet të cilave të arrihej qëllimi që do të përdorej. Në deklaratën *vetting*, por edhe në DIPP-të e viteve 2012-2016, subjekti i rivlerësimit, znj. Entela Prifti, dhe bashkëshorti i saj nuk e kanë deklaruar verandën e objektit dhe qëllimin e përdorimit të saj. Bazuar në nenin D të Aneksit të Kushtetutës, si dhe në nenin 32, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të duhet të deklarojnë plotësisht dhe saktësisht pasuritë e tyre, si dhe burimin e krijimit të tyre. Shpjegimi i subjektit të rivlerësimit se veranda është provizore dhe se mund të kthehet në gjendjen e mëparshme, nuk është i bazuar, pasi, për t'u realizuar ky destinacion i tarracës, ka pasur investime të cilat nuk janë deklaruar dhe, si rrjedhojë, as burimet e krijimit të këtyre shpenzimeve. Subjekti nuk provoi se shpenzimet janë kryer nga shoqëria “{***}”, si dhe nuk ekziston një kontratë qiraje për verandën, ku të specifikohet se shpenzimet për investimet për kthimin e verandës në lokal, janë të qiramarrësit dhe që do të hiqen me përfundimin e kontratës.

Sa më sipër, shkak i pretenduar nga subjekti nuk është i bazuar.

Lidhur me pasurinë “njësi ndërtimi, me sipërfaqe 519 m² ndodhur në Korçë”, me nr. pasurie {}, regjistruar sipas certifikatës për vërtetim pronësie me nr. {***}, lëshuar më datë 11.07.2012, godina “{***}”, në pronësi të bashkëshortit të subjektit, z. P.T., kryer nëpërmjet kontratës së shkëmbimit të aksioneve të shoqërisë “{***}” nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 04.07.2012, Kolegji konstatoi si më poshtë.***

77. Lidhur me këtë pasuri, subjekti i rivlerësimit pretendon në ankim se konstatimi i Komisionit për shkëmbimin e vlerës së transaksioneve dhe fshehjen e vlerës reale të pasurisë “njësi me sipërfaqe 519 m²”, me qëllim fshehjen e burimit të ligjshëm financiar për krijimin e saj, është i pabazuar. Konstatimi i Komisionit se ndërtimi ishte një qendër tregtare dhe se njësia e përfutur ishte njësi tregtare, është i qëllimtë, sipas subjektit.

77.1 Kolegji vëren se subjekti i rivlerësimit në ankim ka sqaruar se bashkëshorti i saj ishte aksioner i shoqërisë së mësipërme, i cili ka zotëruar 8% të aksioneve, nga këmbimi i të cilave ka përfutur një njësi të ndërtuar nga shoqëria “{***}” në katin e {***}-të të godinës “{***}”, në Korçë. Vërehet gjithashtu se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se njësitë në këtë kompleks ndërtimi janë me çmime më të ulëta, duke sjellë edhe dokumente të cilat vërtetojnë se disa kate të ndërtimit janë ende të papërfunduara dhe disa të konfiskuara nga bankat e nivelit të dytë, për shkak të detyrimeve të shoqërisë ndaj tyre.

77.2 Në deklaratën *vetting*, personi i lidhur, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, ka deklaruar se aksionet në masën 8%, në vlerën 14.274.700 lekë, i ka shkëmbyer me pasurinë me sipërfaqe 519 m², në godinën “{***}” në Korçë, ose me vlerë 27.360 lekë/m². Më 31.07.2012, është depozituar vendimi i asamblesë së aksionerëve, datë 25.6.2012, ku është vendosur pranimi i largimit të aksionerit P.T., si dhe miratimi i kontratës së shkëmbimit, me anë të së cilës vërtetohet shkëmbimi i aksioneve me pasurinë e paluajtshme të shoqërisë.

77.3 Kolegji konstaton se vlera me të cilën është shkëmbyer njësia rezulton e ulët krahasuar me tregun, pasi vetëm vlera me kosto ndërtimi, sipas vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 4, datë 23.11.2011, “Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga EKB, për vitin 2011”, i cili është i njëjtë edhe për vitin 2012, rezulton se për qytetin e Korçës është 15.535.746 lekë kosto ndërtimi (29.934 lekë/m²), ndërsa vlera me kosto shfrytëzimi është 18.917.550 lekë (36.450 lekë/m²). Nga ana tjetër, prej vitit 2007, shoqëria “{***}” e zotëron këtë njësi, të cilën e ka ndërtuar vetë, me kosto mesatare ndërtimi 25.317 lekë/m², e cila duke u shumëzuar me sipërfaqen 519 m², rezulton 13.139.523 lekë me kosto ndërtimi, ndërsa 30.301 lekë/m² për sipërfaqe shfrytëzimi, duke e shumëzuar me sipërfaqen 519 m², rezulton shuma 15.726.219 lekë. Nga këto përlllogaritje, rezulton se bashkëshorti i subjektit ka shkëmbyer njësinë me vlerë si më sipër përlllogaritur, ku diferenca ndërmjet vlerës së aksioneve në momentin e shkëmbimit në vitin 2012, me koston mesatare për sipërfaqe ndërtimi në momentin e ndërtimit të godinës në vitin 2007, është relativisht e vogël.

78. Subjekti i rivlerësimit kundërshton konstatimin e Komisionit në lidhje me burimin e ligjshëm të blerjes së 8% të aksioneve në shoqërinë “{***}” dhe deklarin e pamjaftueshëm, mungesën e dokumentacionit ligjor provues, deklarin e rremë dhe mungesën e ligjshmërisë së krijimit të shumave të marra hua nga personat që janë marrë huat, pa kryer analizë të provave të paraqitura nga subjekti. Sipas subjektit, huaja ashtu siç është deklaruar në deklaratën para fillimit të detyrës të vitit 2003, është marrë nga shtetasi A.B. në shumën 5.000.000 lekë dhe nga prindërit e subjektit në shumën 1.000.000 lekë.

78.1 Kolegji vëren se në deklaratën *vetting*, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka deklaruar se vlera e aksioneve të blera me krijimin e shoqërisë në vitin 2003 ishte 6.496.000 lekë. Në lidhje me këtë deklarin, u konstatua se huaja është shlyer me këste, si vijon: në vitin 2008 është shlyer shuma 1.000.000 lekë, në vitin 2010 është shlyer shuma 1.500.000 lekë dhe në vitin 2011 është shlyer shuma 1.500.000 lekë. Ka mbetur detyrim i pashlyer shuma 1.000.000 lekë, të cilën subjekti i rivlerësimit nuk e ka pasqyruar në seksionin përkatës të detyrimeve financiare në deklaratën *vetting*. Gjithashtu, nuk ka paraqitur dokumentacion provues në lidhje me shumën e dhënë hua nga shtetasi A.B., në shumën 5.000.000 lekë, përveç një deklarate noteriale nr. {***} rep., nr. {***} kol., datë 24.09.2018, lëshuar nga znj. V.B., bashkëshortja e të ndjerit A.B., e cila deklaron para noterit se P.T. ka shlyer detyrimin ndaj bashkëshortit të saj dhe pas vdekjes së tij, ndaj saj në vitin 2012 ka shlyer këstin e fundit, pra e ka shlyer të gjithë huan në vlerën prej 5.000.000 lekësh dhe s’ka më detyrime ndaj saj.

78.2 Subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur dokumente që justifikojnë vërtetësinë e deklarimeve për ligjshmërinë e burimit të krijimit të shumës prej 5.000.000 lekësh, të dhënë hua nga ana e huadhënësit A.B., sipas parashikimeve të nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016. Subjekti ka mungesë të dokumentacionit justifikues për të provuar shlyerjen e huas prej 1.000.000 lekësh, prindërve të saj. Personat e tjerë të lidhur, prindërit e subjektit, kanë mungesë të burimit të ligjshëm financiar me dokumentacion justifikues ligjor për të dhënë huan prej 1.000.000 lekësh në vitin 2003 (shih paragrafin 72.3 më sipër).

Shkaku i ngritur nga subjekti nuk gjendet i bazuar.

79. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit pretendon se përveç vërtetimeve të pagave të prindërve, të lëshuara nga DRSSh Korçë, ka paraqitur edhe deklaratat me shkrim dore për dhënien hua të shumave të ndryshme të të hollave ndaj shtetasit V.B., çka vërtetojnë se prindërit kanë pasur të ardhura të mjaftueshme, të cilat vinin nga një burim i ligjshëm, siç është kontrata e huas e rregulluar nga neni 1050 i Kodit Civil.

79.1 Kolegji vëren se lidhur me deklaratat me shkrim dore të babait të subjektit, sipas të cilave jepet hua shuma monetare shtetasit V.B., duke përcaktuar edhe interesin për shumën e dhënë, sa i përket huadhënies me interes, nuk rezulton e provuar të jetë bërë sipas legjislacionit në fuqi. Në këtë rast, pala huadhënëse ka marrë përsipër të japë hua duke kërkuar edhe interes. Vetëm bankat e nivelit të dytë dhe institucionet financiare të licencuara nga organet kompetente, kanë të drejtën të japin para me interes dhe këtë kompetencë e ushtrojnë duke funksionuar sipas legjislacionit në fuqi.

Shkaku i ngritur nga subjekti nuk gjendet i bazuar.

80. Në lidhje me konstatimin e Komisionit në vendim për fshehjen e pjesës takuese të fitimit në shoqërinë “{***}”, për mungesën e dokumenteve që justifikojnë vërtetësinë e deklarimeve për ligjshmërinë e burimit të krijimit të të ardhurave nga fitimi i krijuar gjatë viteve 2007-2009, subjekti i rivlerësimit pretendon se shoqëria nuk ka ndarë në asnjë vit dividendë, por fitimi me vendim i ortakëve ka shkuar për rritjen e kapitalit dhe, nga ana tjetër, kompania e ka paguar tatim fitimin për masën e fitimit të realizuar.

80.1 Kolegji vëren se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur, bashkëshorti, nuk kanë deklaruar pjesën takuese të fitimit në shoqërinë “{***}” në deklaratimet periodike vjetore të dorëzuara pranë ILDKPKI-së, si dhe rritjen e vlerës së aksioneve si rrjedhim i rritjes së kapitalit, nga shuma 6496.000 lekë në vitin 2003 deri në shumën 14.274.880 lekë në vitin 2009.

80.2 Subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se, sipas ligjit nr. 8438/1998, neni 4, germat “e” dhe “f”, burim të ardhurash janë edhe të ardhurat nga dividendët e shpërndarë nga një person juridik dhe të ardhurat nga pjesët e fitimit të paguar nga një ortakëri rezidente. Neni 8 i këtij ligji parashikon si të ardhur të tatueshme në pikën 1/b atë që rrjedh nga fitimi i ortakut apo aksionerit në një shoqëri tregtare. Subjekti i rivlerësimit, znj. Entela Prifti, pretendon se bashkëshorti i saj nuk ka realizuar në asnjë vit të aktivitetit të shoqërisë të ardhura sipas ligjit për tatimin mbi të ardhurat, pasi dividendët nuk i ka tërhequr, por i ka shtuar në kapital, dhe në nenin 33/1 të ligjit nr. 8438/1998 parashikohet se nëse dividendi nuk tërhiqet, nuk kishte detyrimin ligjor të paguante tatim mbi fitimin.

80.3 Nga ana tjetër, rezulton se bashkëshorti i subjektit ka investuar në shoqërinë “{***}” shumën prej 6496.000 lekësh, dividendët e së cilës nuk janë shpërndarë në vite, por kanë kaluar për shtesë kapitali, i cili në vitin 2012, kur bashkëshorti i subjektit është tërhequr nga shoqëria, ka pasur vlerën 14.274.700 lekë. Sipas shkresës së lëshuar nga DRT Korçë me nr. {***} prot., datë 22.06.2018, rezulton se ortakut P.T. nuk ka paguar tatimin mbi të ardhurat e realizuara nga diferenca ndërmjet çmimit të shitjes (14.274.700 lekë) dhe çmimit të blerjes (6.496.000 lekë) së aksioneve, parashikuar nga neni 8, germa “f” e ligjit nr. 8438/1998. Pra, vërtet bashkëshorti i subjektit nuk ka tërhequr dividendë të cilët janë destinuar për shtesë kapitali, por nga ana tjetër

në momentin e shkëmbimit të aksioneve, rezulton të ketë diferencë në drejtim të rritjes së këtij kapitali, çka dëshmon se ka realizuar fitim gjatë këtyre viteve nga investimi fillestar deri në tërheqjen e aksioneve, për të cilin nuk ka paguar fitimin përkatës.

80.4 Në nenin 33/1, pika 1 e ligjit nr. 8438/1998 parashikohet: *Shoqëritë tregtare, sipas ligjit "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", të ndryshuar, pas pagimit të tatimit mbi fitimin, sipas dispozitave të kreut III të këtij ligji, brenda një afati prej 6 muajsh nga data e mbylljes së vitit financiar, duhet të miratojnë në asamblenë e ortakëve apo organin kompetent vendimmarrës të shoqërisë rezultatet financiare të vitit paraardhës dhe ta destinonjë fitimin pas tatimit, duke përcaktuar shumën e rezervave ligjore, pjesën që do të përdoret për investime ose për shtesë kapitali dhe pjesën që do të shpërndahet në formë dividendi.* Sipas parashikimeve të këtij neni, veprimi i parë që kryhet nga shoqëritë, është pagimi i tatimit dhe, pas pagimit të tij, shoqëritë duhet të miratojnë, sipas rezultateve financiare të vitit paraardhës, nëse fitimin pas pagimit të tatimit duhet ta destinonjë për shtesë kapitali apo për shpërndarje dividendi. Sipas pikës 3 të nenit 33/1 më sipër, personi juridik duhet të paguajë për llogari të institucionit tatimor, tatimin mbi dividendin. Nga kjo rrjedh që pasi personi juridik e ka paguar tatimin mbi fitimin, duhet të paguajë edhe tatimin mbi dividendin, i cili është përcaktuar nëse do të shpërndahet gjithmonë pasi personi juridik e ka paguar tatimin mbi fitimin.

80.5 Në rastin e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, nuk jemi përpara faktit të shpërndarjes së dividendit (fitim vjetor i aksionerëve), por për analogji interpretimi, nëpërmjet shkëmbimit është tërhequr fitimi i ortakut, ku shoqëria edhe pse e ka paguar tatimin mbi fitimin për çdo vit, ashtu si në rastin e dividendit, edhe në këtë rast ortakut duhet të paguajë tatimin për fitimin e realizuar. Pavarësisht se në vend të shitjes së aksioneve, bashkëshorti i subjektit me shoqërinë “{***}” ka realizuar shkëmbim të aksioneve me ndërtimin e sipërcituar, ky shkëmbim është realizuar me vlerën e kapitalit tashmë të rritur, në vlerën 14.274.700 lekë, dhe nga kjo rritje e realizuar nuk ka paguar tatim pranë institucioneve tatimore. Gjithashtu, nga blerja e aksioneve në vitin 2003 deri në likuidimin e tyre në vitin 2012, ka një rritje të kapitalit me rreth 7.500.000 lekë, për rritjen e të cilit bashkëshorti i subjektit nuk ka deklaruar në DIPP-të e viteve kur fitimet kanë kaluar për shtesë kapitali.

80.6 Në udhëzimin nr. 5, datë 30.01.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, në pikën 2.3.8/1 të tij parashikohet: *Të ardhurat e realizuara nga diferenca ndërmjet çmimit të shitjes dhe çmimit të blerjes së kuotave të pjesëmarrjes në kapital apo të aksioneve. Në këtë grup përfshihen të ardhurat e realizuara nga shitja e kuotës që një ortak zotëron në një biznes apo ortakëri, apo të ardhurat e realizuara nga shitja e aksioneve. Ndryshe nga grupet e tjera, baza tatimore në këtë rast është diferenca midis të ardhurave nga shitja apo likuidimi i biznesit me vlerën e kontributit në para ose natyrë të ortakëve.* Edhe në rastin konkret, kemi të ardhura të realizuara, të cilat janë shkëmbyer në natyrë sipas masës së aksioneve (8%) dhe vlerës së tyre të shprehur në lekë (14.274.700 lekë), duke krijuar një diferencë të konsiderueshme midis vlerës së blerjes në vitin 2003 dhe vlerës së tyre në momentin e shkëmbimit, për të cilin bashkëshorti i subjektit duhet të kishte paguar tatimin pranë organeve tatimore.

Sa i përket shkakut të ankimit sipas të cilit subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se bashkëshorti nuk kishte detyrimin të paguante tatim sepse e paguan kompania, Kolegji çmon se nuk është i bazuar në ligj e në prova.

- 81. Lidhur me konstatimet për shumat e padeklaruarat të subjektit të rivlerësimit, znj. Entela Prifti, dhe bashkëshortit të saj,** subjekti i rivlerësimit në ankim kundërshton përfundimin e Komisionit në lidhje me mosdeklarimin e shumës 2.000.000 lekë, duke shpjeguar se e ka provuar me dokumente shkresore se kjo shumë i është dhuruar bashkëshortit të subjektit nga babai i tij në vitin 2008, e cila kishte qenë më parë e investuar nga ky i fundit në bono thesari në Bankën e Shqipërisë.

81.1 Kolegji konstatoi se nga bashkëshorti i subjektit është deklaruar shuma e mësipërme në DIPP-në e vitit 2008, ndërsa nuk rezulton e deklaruar nga vetë subjekti, me pretendimin se është shumë e cila është përfituar nga dhurimi. Në nenin 77, germa “b” e Kodit të Familjes parashikohet se: *Pasuri vetjake e bashkëshortit që nuk bën pjesë në bashkësi është [...] “pasuria e fituar gjatë martesës me anë të dhurimit, të trashëgimisë ose legut, kur në aktin e dhurimit ose në testament nuk përcaktohet se ato janë dhënë në favor të bashkësisë.* Nga ky parashikim ligjor, i cili e përjashton subjektin nga bashkëpronësia, rezulton se subjekti nuk kishte detyrimin ligjor ta deklaronte shumën e mësipërme.

Sa i përket shkakut të mësipërm, të ngritur nga subjekti, Kolegji vlerëson se është i bazuar në ligj dhe, për pasojë, konkluzioni i Komisionit për këtë fakt është i gabuar.

- 82. Lidhur me kreditimin e shumës 70.000 USD në llogarinë e bashkëshortit të subjektit në Credins Bank,** sipas subjektit kjo vlerë nuk i takonte as asaj dhe as bashkëshortit të saj, por një mikes së familjes, saktësisht znj. E.Dh., deklarata e së cilës nuk u mor parasysh nga Komisioni. Shuma e sipërcituar është tërhequr përsëri prej znj. Dh., që është dhe pronare e shumës. Sipas pretendimit të subjektit të rivlerësimit në ankim, sikur të ishte e saj, duhet të vërtetohej që kjo shumë është përdorur diku apo është fshehur diku, pasi veprimet bankare janë të gjitha të regjistruara.

82.1 Kolegji vëren se në dokumentacionin e administruar në dosje, rezulton një çek i datës 20.10.2008, në vlerën 70.000 USD nga Alpha Bank Greqi, i cili i është paguar z. P.T. nga V.O. Nuk rezulton nga dokumentacioni në dosje nëse urdhëruesi i mësipërm është E.Dh. apo person tjetër, për këtë nuk është pyetur as subjekti i rivlerësimit. Ky çek është arkëtuar në Bankën Credins në datën 21.10.2008 në llogarinë e z. P.T. Në datën 20.11.2008, kjo vlerë është transferuar në llogari tjetër, me nr. {***}, të z. P.T. dhe nga kjo shumë është tërhequr vlera 40.000 USD. Në datën 07.02.2009, vlera 29.800 USD është kaluar në llogarinë e znj. E.Dh. po në të njëjtën bankë. Rezulton se asnjë nga veprimet e mësipërme nuk është deklaruar nga subjekti dhe bashkëshorti i saj në DIPP apo në deklaratën *vetting*.

Sa i përket shkakut të mësipërm, nuk gjendet i bazuar.

- 83. Lidhur me depozitën në emër të bashkëshortit të subjektit në shumën 10323 euro,** sipas subjektit, Komisioni ka shkelur ligjin sepse është deklarata *vetting* ajo që pasqyron pasuritë e subjektit të rivlerësimit dhe deklarata para fillimit të detyrës e vitit 2003 nuk është objekt hetimi. Subjekti më tej shton se edhe sikur të ishte pjesë e hetimit, deklarata para fillimit të

detyrës e vitit 2003, përsëri nuk do të kishim fshehje të pasurisë, sepse shuma e pretenduar si e fshehur ka qenë në llogaritë bankare të bashkëshortit të subjektit dhe përfaqëson vlerën e kthyer të kredisë së marrë për blerjen e banesës, e cila ka kaluar në depozitë kursimi dhe më pas është tërhequr nga banka përkatëse, pas përfundimit të kësaj kontrate.

83.1 Kolegji arsyeton se sa i përket pretendimit mbi deklaratën para fillimit të detyrës së vitit 2003, neni 32, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 parashikon: “Deklarimet e interesave privatë dhe pasurorë, të paraqitura më parë tek ILDPKI-ja mund të përdoren si provë nga Komisioni dhe Kolegji i Apelit”. Në nenin 30 të ligjit nr. 84/2016, në lidhje me procesin e rivlerësimit të pasurisë, objekti i këtij vlerësimi është deklarimi dhe kontrolli i pasurive, i ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, i përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur të tij, elemente këto të cilat rezultojnë edhe nga deklarimet periodike të pasurisë së subjekteve të rivlerësimit. Duke qenë se përcaktimet kushtetuese dhe ligjore të sipërcituara u kanë dhënë deklarimeve periodike të pasurisë vlerën e provës, Komisioni apo Kolegji këto deklarata, së bashku me provat e tjera, i vlerëson në tërësi dhe harmoni me rrethanat e çështjes, për të arritur në një konkluzion sa më të drejtë.

84. Lidhur me depozitimin *cash* të shumës 12045 USD në NBG Bank dhe transfertën në {*} të kësaj shume**, sipas ankimit të subjektit shuma që është transferuar ka qenë një pagesë e bashkëshortit të subjektit, lindur nga një detyrim i krijuar vite më parë. PAGESA është kryer nga të ardhurat e bashkëshortit të subjektit nga puna dhe kursimet familjare. Sipas subjektit, duke qenë se ky veprim është kryer në vitin 2002, nuk kishte arsye përse të deklarohet në deklaratën para fillimit të detyrës së vitit 2003, duke qenë se ligji nr. 9049/2003 përcakton se deklarimi i parë ngarkon subjektet të deklarojnë në çastin e hyrjes në fuqi të ligjit pasuritë e akumuluar, detyrimet financiare, burimet dhe origjinën e tyre. Gjithashtu, sipas subjektit, nuk ka asnjë kolonë në deklaratën para fillimit të detyrës së vitit 2003, ku mund të deklarohet një detyrim i plotësuar.

84.1 Në ligjin nr. 9049/2003, varianti fillestar dhe i pandryshuar akoma, në nenin 6 të tij për deklarimin e parë parashikohet: *Të gjitha subjektet e përcaktuara në nenin 3, që mbartin detyrimin për deklarim, në çastin e hyrjes në fuqi të këtij ligji, detyrohen të deklarojnë të gjitha pasuritë e akumuluar, detyrimet financiare dhe burimet e origjinën e tyre.* Ndërsa në nenin 4 për afatin dhe objektin e deklarimit parashikohet: *Subjektet e përcaktuara në nenin 3 të këtij ligji detyrohen të deklarojnë në Inspektoratin e Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe në inspektoratet e ulëta, brenda datës 31 mars të çdo viti, gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit paraardhës të pasurive, burimet e krijimit të tyre, si dhe të detyrimeve financiare si më poshtë [...].* Sipas këtij parashikimi ligjor, subjekti ka pasur afat për të deklaruar deri më 31.03.2004 për gjendjen deri më 31 dhjetor të vitit 2003. Veprimi i transferimit të shumës në {***} nga bashkëshorti i subjektit është kryer në vitin 2002, ndaj këtë detyrim financiar nuk ishte i detyruar, sipas ligjit, ta deklaronte, pasi nuk përfshihej në periudhën e deklarimit. *Lidhur me këtë shkak ankimi, nga Kolegji vlerësohet se pretendimi i subjektit të rivlerësimit është i bazuar në ligj.*

85. Lidhur me depozitim e shumës prej 3.600.000 lekë cash në Credins Bank, sipas ankimit, në kundërshtim me qëndrimin e Komisionit, subjekti i rivlerësimit shpjegon se veprimet e kryera në bankë lidhur me shumën 3.600.000 lekë, janë brenda së njëjtës ditë, 17 gusht 2007, si hapja e llogarisë, këmbimi dhe tërheqja e shumës, ndaj kjo e fundit nuk i përkiste bashkëshortit të subjektit, por shtetasit L.L., i cili ushtron veprimtari tregtare në qytetin e Korçës. Subjekti i rivlerësimit pretendon se llogaria është mbyllur automatikisht në datën 02.10.2007, pasi nuk ka pasur fonde për të paguar komisionin e saj, por shuma është tërhequr në datën 17.08.2007, dhe jo siç i rezulton Komisionit. Ky veprim është kryer për të përfitur nga kursi preferencial që subjekti përfitonte nga banka.

85.1 Kolegji vëren se nga rezultatet e faqes zyrtare të Bankës së Shqipërisë, rezulton se kursi i këmbimit kundrejt euros në kohën në fjalë ka qenë në vlerën 121,35 lekë, ndërsa kursi që subjekti i rivlerësimit ka marrë nga banka është në vlerën 121,5 lekë. Nga këto të dhëna rezulton se kursi nga banka e nivelit të dytë ndryshon me 0,15 pikë, të cilat në rastin e subjektit nuk vlerësohet nga Kolegji se janë favorizuese. Subjekti i rivlerësimit dhe bashkëshorti i saj nuk kanë deklaruar këtë veprim në DIPP-në e vitit 2007 dhe as në deklaratën *vetting*.

85.2 Pretendimi i subjektit të rivlerësimit se shuma 3.600.000 lekë ka qenë e z. L.L., mik fëmijërie me personin e lidhur/bashkëshortin e subjektit të rivlerësimit, nuk u provua me dokumentacion. Deklarata noteriale me nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 21.09.2018, e paraqitur nga ky individ, nuk ka efekt provues në këtë proces, pasi është kryer gjatë procesit të rivlerësimit, çka të krijon bindjen se është konceptuar në favor të deklarimeve të subjektit të rivlerësimit, edhe se nuk mbështetet nga provat e tjera të administruara në procesin e rivlerësimit, si rrjedhojë nuk mund të ketë vlerë provuese bindëse në këtë proces.

86. Lidhur me të ardhurat e bashkëshortit të subjektit, të realizuara nga kontrata e qirasë me shoqërinë “{*}”**, subjekti deklaron se ka provuar me dokumentacion, si kontrata e qirasë dhe vërtetimi i Drejtorisë së Tatimeve Korçë, pagesën e vlerës së tatimit në burim. Gjithashtu, pretendon se vlerat e deklaruara janë të sakta si në deklaratën *vetting* dhe për këtë të ardhur është vërtetuar para Komisionit se janë paguar detyrimet tatimore në organin kompetent, pra plotësohen të gjitha kërkesat e nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

86.1 Kolegji vëren se Komisioni ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të rremë për të ardhurat nga qiraja me shoqërinë “{***}” në vlerën 13.500 euro, me arsyetimin se shoqëria ka kryer aktivitet në ndërtesën e ndodhur në Korçë, {***}, nr. {***}, vetëm gjatë periudhës 13.08.2012 - 02.12.2013 (7 muaj), ndërsa deklaruar nga bashkëshorti i subjektit prej marsit 2012 (12 muaj).

86.2 Komisioni i ka drejtuar një shkresë Drejtorisë Rajonale Tatimore Korçë për informacion për shoqërinë “{***}” dhe me përgjigjen e ardhur nga kjo drejtori me nr. {***} prot., datë 27.03.2018, rezulton se shoqëria “{***}” ka kryer pagesën e tatimit në burim për ambientin e marrë me qira nga viti 2012 deri në vitin 2018. Nga analiza e kryer në Kolegji, lidhur me periudhën ku Komisioni konkludon se është paguar qira vetëm për 7 muaj, rezulton se për vitin 2012 është paguar vlera 412.500 lekë tatim në burim, i cili është i barabartë me 10% të vlerës totale të qirasë për 10 muaj. Për sa më sipër, përputhet deklarimi i subjektit të

rivlerësimit në lidhje me të ardhurat nga kontrata e qirasë dhe gjithashtu e konfirmuar kjo edhe nga DRT Korçë.

Pretendimi i subjektit të rivlerësimit për shkakun e mësipërm të ankimit, nga Kolegji vlerësohet se është i bazuar në prova dhe, për pasojë, konkluzioni i Komisionit për këtë fakt rezulton i gabuar.

87. Për sa i përket vlerës së investuar nga shoqëria “{*}” për arredimin e kthimin në lokal shërbimi të objektit,** subjekti shpjegon se investimi në godinë ka ardhur si pasojë e një marrëveshjeje midis kësaj shoqërie dhe bashkëshortit të subjektit, e cila specifikon se shoqëria do të kryente punimet dhe përshtatjen e godinës në lokal shërbimi dhe për këtë nuk do të paguante qira për periudhën prill-dhjetor 2013. Subjekti shpjegon se nuk ka qenë detyrim i tij të dinte se sa është vlera e punimeve, për sa kohë, sipas marrëveshjes, nuk ishin të kompensueshme, dhe kjo mosdijeni nuk mund të sillte pasoja ndëshkuese për subjektin. Në lidhje me këtë shkak ankimi, referojuni paragrafit 75.2 më sipër, arsyetimi në të cilin vlen edhe në këtë rast.

88. Lidhur me të ardhurat nga kontrata e qirasë me shoqërinë “{*}”,** subjekti i rivlerësimit kundërshton analizën e provave të bëra nga Komisioni dhe të rrethanave të sqaruara plotësisht për të ardhurat e deklaruara nga subjekti, që rrjedhin nga kontratat e qirasë me shoqërinë “{***}”, të lidhura me bashkëshortin e saj. Ato duhet të konsiderohen si burim i ligjshëm të ardhurash, pasi janë rrjedhojë e një kontrate qiraje të ligjshme, të vlefshme dhe të pakundërshtuar, për këto të ardhura është mbajtur tatimi në burim, sipas përcaktimeve të nenit 33 të ligjit “Për tatimin mbi të ardhurat”.

88.1 Kolegji vëren se për të provuar pagesën e tatimit në burim, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në Komision një shkresë në të cilën DRT Korçë i përgjigjet znj. V.Sh. (administratore e “{***}”), me nr. {***} prot., datë 24.01.2017, me anë të së cilës konfirmohet se shoqëria “{***}” ka deklaruar rregullisht tatim në burim (për qira ambienti) për periudhën 2014 e në vazhdim pranë DRT Korçë dhe se kontrata e fundit e qirasë e dorëzuar në organin tatimor është e datës 05.01.2016, me qiradhënës P.T., me vlerë 240.000 lekë në muaj.

88.2 Komisioni gjatë hetimit administrativ të tij ka marrë një përgjigje nga DRT Korçë me nr. {***} prot., datë 08.05.2017, Drejtoria e Kontrollit Tatimor, ku specifikohet se për vitin 2014 nuk rezulton pagesë për tatimin në burim sipas informacionit të marrë nga zyra e kontabilitetit për këtë periudhë. Në këtë rast, vihet re një mospërputhje në informacionin e paraqitur nga institucionet e tatimeve për Komisionin dhe për subjektin, pasi një tjetër shkresë e paraqitur në Komision nga subjekti i rivlerësimit është edhe shkresa me nr. {***} prot., datë 26.09.2018, ku DRT Korçë, Drejtoria e Kontrollit Tatimor, i përgjigjet znj. V.Sh. se pas verifikimit të kryer konfirmohet se është bërë pagesa e tatimit në burim për vitin 2014. Duke pasur parasysh këto fakte kronologjike dhe mospërputhjen e shkresës së ardhur nga Drejtoria Rajonale Tatimore gjatë procesit të rivlerësimit, krahasuar me shkresën e mëparshme të të njëjtit institucion, Kolegji nuk bindet që pretendimet e subjektit për pagimin e tatimit në burim janë të bazuara.

89. Për sa i përket konstatimit të Komisionit për të ardhurat e dyshimta nga qiraja me shoqërinë “{*}” për periudhën 2015-2016,** duke analizuar veprimtarinë tregtare të shoqërisë, është i pabazuar dhe aktiviteti i kësaj shoqërie nuk është objekt shqyrtimi i Komisionit. Sipas subjektit, pjesa e pagimit të qirasë është e paraqitur në të gjitha bilancet e shoqërisë, të administruara në dosje së bashku me pagesën e tatimit në burim.

89.1 Për sa u përket viteve 2015-2016, kur kompania “{***}” ka rezultuar me humbje ose me fitim shumë të ulët, Komisioni ka konkluduar se kjo kompani nuk mund të kishte shpenzime qiraje të larta për shkak të fitimeve të ulëta. Kolegji vlerëson se pavarësisht gjendjes së të ardhurave që ka gjeneruar kompania më sipër, pagesat për tatimin në burim janë kryer dhe rezultojnë të provuara nga subjekti, si rrjedhojë shkak i ankimit i pretenduar nga subjekti është i bazuar dhe, për pasojë, konkluzioni i Komisionit për këtë fakt rezulton i gabuar.

90. Lidhur me të ardhurat nga qiraja për banesën në Bulevardin {*},** subjekti kundërshton konstatimin e Komisionit si deklaram i rremë, duke shpjeguar se Komisioni nuk ka marrë në shqyrtim provat shkresore që sqarojnë plotësisht situatën. Marrëdhënia e qirasë është krijuar midis një personi fizik dhe bashkëshortit të subjektit me vullnetin e tyre të lirë. Ka qenë zgjedhja e qiramarrësit që ka përcaktuar mënyrën e pagimit të vlerës së qirasë dhe kjo zgjedhje nuk ngarkon me përgjegjësi qiradhënësin. Shuma 2200 euro është e ardhur e krijuar nga një kontratë qiraje e ligjshme, për të cilën janë paguar detyrimet tatimore dhe, si e tillë, plotëson kërkesat e nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

90.1 Kolegji vëren se Komisioni ka konkluduar se subjekti i rivlerësimit ka kryer deklaram të rremë për të ardhurat nga qiraja në shumën 2200 euro, nga kontrata e qirasë së lidhur me shoqërinë “{***}”, Itali, pasi nuk konfirmohen nga organet tatimore dhe mungon dokumenti justifikues ligjor për shlyerjen e detyrimeve ndaj shtetit për tatimin në burim.

90.2 Sipas shkresës nr. {***} prot., datë 19.12.2017, të DRT Korçë, drejtuar ILDKPKI-së, rezulton se në sistemin elektronik të tatimeve nuk ka asnjë subjekt të regjistruar me emrin “{***}” ShPK. Kontrata e qirasë, e sjellë nga subjekti i rivlerësimit, është një kontratë në gjuhën angleze, ku specifikohet se tatimin mbi qiranë do ta paguajë qiradhënësi. Kjo kontratë qiraje mban datën 07.01.2016. Subjekti i rivlerësimit ka paraqitur dokumentacionin në Komision, me anë të të cilit synon të provojë të ardhurat nga qiraja e këtij viti. Në dokumentacionin e administruar nga Komisioni, rezulton se subjekti ka sjellë kopje të plotësuara të deklaratës individuale vjetore të të ardhurave (DIVA) të bashkëshortit. Në këtë deklaratë të vitit 2016, rezulton i deklaruar tatimi i mbajtur në burim për qiranë dhe i paguar në Bankën Credins, sipas mandatpagesës së kësaj banke, tatimi mbi të ardhurat individuale. Nga sa më sipër, rezulton e provuar se është paguar tatimi mbi të ardhurat nga qiraja për vitin 2016 për të ardhurat nga qiraja e banesës në bulevardin {***}. Konkluzionet e Komisionit në vendim, lidhur me këtë shkak ankimi, nuk janë të bazuara.

91. Lidhur me të ardhurat dhuratë nga prindërit e bashkëshortit të subjektit, sipas subjektit, konstatimi i Komisionit si deklaram i rremë dhe mungesë burimi të ligjshëm për krijimin e tyre, është tërësisht i pabazuar në provat e paraqitura nga subjekti, të cilat janë lëshuar nga organet kompetente.

91.1 Kolegji vëren se nga dokumentacioni i administruar në Komision, për të përlogaritur mundësinë për kursim të vlerës 1.600.000 lekë të z. B.T., rezulton se të ardhurat e përfituara nga pensioni nuk janë të mjaftueshme për krijimin e kësaj shume. Lidhur me këtë analizë, referoju paragrafit nr. 60.4 të këtij vendimi. Gjithashtu, bazuar në dokumentacionin e administruar në dosjen e Komisionit, rezulton se të ardhurat e tyre për këto vite nuk do të mjaftonin për të investuar në bono thesari në vlerën 300.000 lekë babai i bashkëshortit në vitin 2004 dhe në vlerën 900.000 lekë nëna e bashkëshortit në vitin 2002.

92. Lidhur me denoncimin anonim për pasuri të fshehura të subjektit të rivlerësimit, subjekti pretendon se Komisioni nuk ka kryer hetim për të vërtetuar nëse denoncimi është i bazuar. Gjithashtu, për këtë rast, subjekti ankon faktin se kuptimi i personit të lidhur nuk është çdo person me të cilin hyn në një marrëdhënie financiare. Huaja e dhënë ndaj motrës prej subjektit nuk është vërtetuar që lidhet me krijimin e pasurive prej saj. Pasuritë e krijuara nga motra janë për një hark të gjerë kohor prej 10 vjetësh dhe për një vlerë të konsiderueshme. Huaja prej 550.000 lekësh është një shumë e vogël, krahasuar me shumën e investuar për krijimin e këtyre pasurive. Subjekti ankon faktin se konstatimi i Komisionit në vendim se përputhen të dhënat e adresave të denoncimit me adresat e familjarëve të subjektit, nuk mund të konsiderohet si i bazuar. Sipas subjektit, motra e saj nuk mund të konsiderohet si person i lidhur, duke e konsideruar këtë qëndrim të Komisionit si tërësisht në kundërshtim me ligjin.

92.1 Kolegji vëren se Komisioni ka regjistruar një denoncim anonim, nëpërmjet të cilit pretendohet se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar pasuri që i përkasin asaj. Denoncuesi referon katër apartamente, ku sipas tij i përkasin subjektit të rivlerësimit, nga të cilët njëri është regjistruar në pronësi të motrës së subjektit, një në pronësi të bashkëshortit të motrës, një në pronësi të babait të subjektit dhe një tjetër nuk dihet se kujt i përket. Komisioni, bazuar në nenin 53 të ligjit nr. 84/2016, kreu hetim kryesisht duke kërkuar informacion pranë organeve shtetërore dhe private në lidhje me personat që disponojnë këto pasuri dhe, bazuar në indiciet e përmendura në denoncim.

92.2 Nga hetimi administrativ, Komisioni ka konkluduar se, si adresa e pasurive në pronësi të babait të subjektit dhe bashkëshortit të motrës së subjektit të rivlerësimit, po ashtu dhe emri i pronarit përputhen me të dhënat e denoncimit. Komisioni ka arritur në përfundimin se ekzistojnë dyshime të arsyeshme dhe të forta se subjekti i rivlerësimit mund të ketë pasuri më të madhe se dyfishi i pasurisë së ligjshme dhe subjekti është përpjekur të fshehtë pasuritë të cilat figurojnë të regjistruara në emër të motrës, në emër të bashkëshortit të motrës dhe në emër të babait të saj.

92.3 Subjekti i rivlerësimit ka konfirmuar marrëdhënien e interesit me babanë e saj, pasi ky i fundit në vitin 2003 i ka dhënë hua bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit shumën prej 1.000.000 lekësh, për të blerë aksione në shoqërinë “{***}” ShPK. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka konfirmuar marrëdhëniet e interesit me motrën dhe bashkëshortin e saj nëpërmjet huas së dhënë, pagesave periodike të kryera në vitin 2014, si dhe huan prej 550.000 lekësh dhënë motrës.

92.4 Neni 3, pika 14 e ligjit nr. 84/2016 parashikon: *Persona të tjerë të lidhur janë personat fizikë ose juridikë, që duket se kanë ose kanë pasur lidhje interesi me subjektin e rivlerësimit, komisionerin, gjyqtarin ose komisionerin publik që rrjedh nga një interes pasuror ose çdo marrëdhënie tjetër biznesi.* Neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016 parashikon: *Subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, ose persona të tjerë të lidhur, të deklaruar në cilësinë e dhuruesit, huadhënësit ose huamarrësit, nëse konfirmojnë këto marrëdhënie, kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurive.* Në kuptim të dispozitave të mësipërme, është konfirmuar statusi ligjor i babait, motrës dhe bashkëshortit të motrës së subjektit të rivlerësimit si persona të tjerë të lidhur, pasi janë deklaruar në cilësinë e huadhënësit ose huamarrësit. Për këtë marrëdhënie nuk ka kontrata huamarrjeje, por është konfirmuar nga vetë subjekti si dhe është deklaruar në DIPP.

92.5 Në analizë të sa më sipër, subjekti i rivlerësimit gjendet para situatës së parashikuar prej nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, sipas së cilës ai duhet të ketë detyrimin të provojë ligjshmërinë e burimit të krijimit të asaj pasurie, e cila është objekt dhurimi apo huaje, pa u shtrirë ky detyrim mbi të gjitha pasuritë që kanë personat e tjerë të lidhur. Interpretimi në të kundërt i kësaj dispozite konsiderohet se shkel parimin e proporcionalitetit, pasi e ngarkon subjektin me një barrë përtej asaj që ai ligjërisht është ngarkuar të mbajë dhe barazon statusin e një shtetasi tjetër, personit tjetër të lidhur, që përgjithësisht nuk ka figuruar të ketë qenë subjekt deklarues, me atë të vetë subjektit të rivlerësimit, një mision që del jashtë qëllimit të ligjit e për më tepër duket edhe i pamundur⁸.

92.6 Për ta lidhur konkretisht me rrethanat e çështjes në rastin e huadhënies me motrën dhe kunatin, është vetë subjekti i rivlerësimit që i ka dhënë hua, nga e cila rezulton se ka pasur burime të mjaftueshme ta japë atë në vitin 2015, pra nuk jemi para rastit të huamarrjes nga subjekti për të analizuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë së personave të tjerë të lidhur. Nga ana tjetër, lidhur me huan (1.000.000 lekë) dhënë nga babai i subjektit për blerjen e aksioneve në shoqërinë “{***}” në vitin 2003, rezulton që personi tjetër i lidhur, babai, të mos ketë burime të mjaftueshme për të dhënë hua në këtë shumë, por për ta lidhur me apartamentin që ky i fundit ka blerë në vitin 2010 (apartamenti i denoncuar) kemi një fragmentim kohor, i cili zbeh dyshimin për ekzistencën e pasurisë së fshehur, që do të thotë se mungesa e ligjshmërisë së burimit të krijimit të pasurisë nga babai në vitin 2003, nuk çon në bindjen e Kolegjit se pasuria e blerë në vitin 2010 është pasuri e subjektit të rivlerësimit.

92.7 Për Kolegjin, në këtë rast, nuk mjafton vetëm ekzistenca e marrëdhënies së huas ndërmjet këtyre personave, si dhe përputhja e adresave të denoncuar me ato të personave të tjerë të lidhur, për të arritur në konkluzionin se janë pasuri të fshehura të subjektit të rivlerësimit. Nuk rezulton të jetë hetuar më tej nga Komisioni për të mbledhur dokumente të tjera, si: fatura energjie, ujësjellësi apo indicie të tjera që subjekti mund të ketë banuar aty, apo e ka referuar diku si adresë banimi.

Në analizë dhe sintezë të sa më sipër, rrethanat e paqarta të konstatuara në lidhje me denoncimin mund të sqaroheshin vetëm nëpërmjet një hetimi më të thelluar në Komision, të legjitimuar nga ekzistenca e dyshimeve për pasuri të fshehura të subjektit të rivlerësimit. Por,

⁸ Vendimi nr. 15/2019(JR), paragrafi 110.

Kolegji në analizë të shkaqeve të tjera të ankimit të subjektit të rivlerësimit, arrin në konkluzionin se shkaqet e ankimit në lidhje me pasuri të fshehura nga subjekti i rivlerësimit, pavarësisht se gjenden të drejta, nuk gjenden të mjaftueshme për të ndryshuar vendimin e Komisionit dhe çështja e dyshimeve për fshehje pasurie shihet e panevojshme për t'iu nënshtruar hetimeve të mëtejshme në Kolegj.

VI. Konkluzionet e trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

Kolegji, pasi shqyrtoi pretendimet dhe shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit, si dhe provat e administruara gjatë hetimit nga Komisioni për këtë çështje në seancë gjyqësore, zhvilluar në dhomë këshillimi, arrin në përfundimet e mëposhtme.

- I. Nga analiza ligjore dhe financiare lidhur me pasurinë “apartament banimi me sipërfaqe 55 m², me nr. pasurie {***}, me adresë rr. “{***}” Korçë”, pasuri bashkëshortore me vlerë 2835.500 lekë, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare, shoqëruar me dokumentacion ligjor justifikues për blerjen e këtij apartamenti, ndaj bazuar në nenin D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, subjekti nuk arriti të justifikojë me burime të ligjshme krijimin e kësaj pasurie të paluajtshme. Në konkluzion të analizës për këtë pasuri, Kolegji çmoi se subjekti është në kushtet e mungesës së burimeve financiare të ligjshme lidhur me kriterin e kontrollit të pasurisë, sipas nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.
- II. Lidhur me pasurinë “apartament banimi me sipërfaqe 70 m², me nr. pasurie {***}, me adresë në lagjen nr. {***}, rr. “{***}”, Korçë”, në bashkëpronësi të subjektit me prindërit, shitur me kontratën nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 04.04.2005, në vlerën 1.950.000 lekë, rezulton se subjekti nuk justifikoi ligjërisht diferencën mes çmimit të shitjes së deklaruar në DIPP-në e vitit 2005 dhe çmimit të shitjes sipas kontratës së sipërcituar, për pasojë rezulton se subjekti është përpjekur të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasurinë, nuk arriti të provojë të kundërtën e fakteve të konstatuara në Komision, në përputhje me nenin D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës. Në konkluzion të analizës për këtë pasuri, Kolegji çmoi se bazuar në nenin 33, pika 5, germa “ç” e ligjit nr. 84/2016, subjekti ka kryer deklaram të rremë në lidhje me deklarin e çmimit të shitjes së këtij apartamenti.
- III. Lidhur me pasuritë e luajtshme automjete, tip “Renault” dhe tip “Benz DaimlerChrysler”, Kolegji vlerëson se çmimet e shitjes së këtyre automjeteve janë shumë më të larta se çmimet e blerjes edhe pas përdorimit dhe konsumimit të tyre, ndaj arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit, bazuar në nenin 33, pika 5, shkronja “ç” e ligjit nr. 84/2016, ka kryer deklaram të rremë për këto pasuri.
- IV. Nga analiza ligjore dhe financiare lidhur me apartamentin e banimit “dupleks, me sipërfaqe 235 m², me nr. pasurie {***}, ndodhur në rr. {***}, Korçë”, rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk paraqiti dokumente që justifikojnë vërtetësinë e deklarimeve për ligjshmërinë e burimit të krijimit të kësaj pasurie, ndaj në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të justifikojë me burime të ligjshme krijimin e kësaj pasurie të paluajtshme. Në konkluzion të analizës për këtë pasuri, Kolegji

çmoi se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme, lidhur me kriterin e kontrollit të pasurisë, sipas nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

- V. Lidhur me pasurinë “banesë me sipërfaqe 198 m², me nr. pasurie {***}, ndodhur në {***}, Korçë”, Kolegji çmoi se subjekti i rivlerësimit është përpjekur të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasurinë dhe nuk arriti të provojë të kundërtën e fakteve të konstatuara në Komision, sipas parashikimeve të nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës, për pasojë subjekti, bazuar në nenin 33, pika 5, shkronja “ç” e ligjit nr. 84/2016, ka kryer deklaram të remë.
- VI. Nga analiza ligjore dhe financiare për pasurinë “njësi shërbimi me sipërfaqe 519 m², ndodhur në Korçë”, Kolegji çmoi se për këtë pasuri nuk është shpjeguar bindshëm burimi i ligjshëm në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe rezulton se subjekti i rivlerësimit është përpjekur të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasurinë në pronësi dhe ka dështuar të provojë të kundërtën e fakteve të konstatuara në Komision, në kuptim të nenit D, pika 5 e Aneksit të Kushtetutës. Në konkluzion të analizës për këtë pasuri, subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme, lidhur me kriterin e kontrollit të pasurisë sipas nenit 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.
- VII. Lidhur me të ardhurat dhuratë nga prindërit e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit, ku ky i fundit ka kundërshtuar konstatimin e Komisionit për këtë shumë si të padeklaruar nga personi i lidhur/bashkëshorti i subjektit, Kolegji arriti në përfundimin se bazuar në nenin 33, pika 5, shkronja “b”, ka mungesë të burimeve të ligjshme financiare për krijimin e kësaj shume.
- VIII. Lidhur me vlerësimin tërësor në lidhje me kriterin e pasurisë, Kolegji, bazuar në përfundimet e mësipërme dhe në vlerësimin tërësor të procedurave për kriterin e vlerësimit të pasurisë, arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut të sistemi i drejtësisë dhe ndodhet në kushtet e pamundësisë për plotësimin e mangësive nëpërmjet programit të trajnimit, duke bërë kështu të aplikueshme kërkesat e nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016.
- IX. Kolegji, pasi shqyrtoi shkaqet e tjera të ankimit të subjektit të rivlerësimit, arriti në konkluzionin se ato nuk gjenden të mjaftueshme për të ndryshuar vendimin e Komisionit.
- X. Në përfundim, Kolegji, bazuar në konkluzionet e mësipërme, në mbështetje të nenit D, pikat 3 dhe 5 të Aneksit të Kushtetutës, si dhe të nenit 61, pikat 3 dhe 5 të ligjit nr. 84/2016, çmon se vendimi i Komisionit nr. 69, datë 27.12.2018, është i drejtë, i bazuar në prova e në ligj dhe, si i tillë, duhet lënë në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në nenin 66, pika 1, germa “a” e ligjit nr. 84/2016,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 69, datë 10.10.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit, znj. Entela Prifti.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.
U shpall më datë 02.12.2019, në Tiranë.

ANËTAR

Luan DACI

nënshkrimi

ANËTARE

Ina RAMA

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

RELATOR

Ardian HAJDARI

nënshkrimi

KRYESUESE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

MENDIM PARALEL

1. Unë, gjyqtare Ina Rama, kam votuar pro qëndrimit të mbajtur në vendimin e shumicës, për sa u përket të gjitha argumenteve të arsyetuara në vendim, të cilat legjitimojnë lënien në fuqi të vendimit nr. 69, datë 10.10.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit, znj. Entela Prifti, por jam shprehur kundër qëndrimit të shumicës së trupit gjykues, për sa i përket konsiderimit si shkak shkarkimi për këtë subjekt rivlerësimi të cenimit të besimit të publikut te sistemi i drejtësisë, në kuptim të nenit 61 pika 5 e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve e prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”).
2. Ky qëndrim, ndonëse nuk afekton vendimmarrjen e Kolegjit, lidhet me një arsyetim të ndryshëm rreth zbatimit të dispozitës së mësipërme në rastet kur subjektet e rivlerësimit janë vlerësuar vetëm mbi bazën e një kriteri rivlerësimi, arsyetim i mbajtur prej meje edhe në çështje të tjera të ngjashme.
3. Siç rezulton nga vendimi objekt shqyrtimi, subjekti i rivlerësimit i është nënshtruar procesit të rivlerësimit dhe është shkarkuar nga detyra, mbështetur në kontrollin dhe vlerësimin e vetëm një kriteri, që është ai i pasurisë. Brenda këtij kriteri, ashtu si Komisioni, edhe Kolegji ka gjetur një sërë shkeljesh nga ato që parashikon neni 33, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, që justifikojnë klasifikimin e subjektit në kushtet e deklaramit të pamjaftueshëm, në kuptim të nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016, situatë e cila shërben si bazë ligjore për të urdhëruar shkarkimin e subjektit nga detyra.
4. Përtej këtyre shkaqeve, me të cilat jam dakordësuar plotësisht, Kolegji ka vlerësuar si të drejtë qëndrimin e Komisionit se sjellja e subjektit, e materializuar pikërisht në këto shkelje të ligjit nr. 84/2016, të parashikuara nga neni 33, pika 5, duhet të konsiderohet njëkohësisht edhe si një bazë për aplikimin e nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016, sepse kjo sjellje konsiderohet se ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë.
Organet e rivlerësimit kryejnë rivlerësimin e subjekteve të rivlerësimit sipas parashikimit të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, e cila parashikon se:
Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit. Vendimi merret bazuar në një ose disa prej kriterëve, në vlerësimin e përgjithshëm të tri kriterëve, ose në vlerësimin tërësor të procedurave.
Ndërkohë neni 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 që rregullon cenimin e besimit të publikut te drejtësia si një shkak autonom shkarkimi parashikon se:
Në rast se nga vlerësimi tërësor, në kuptim të nenit 4, pika 2 e këtij ligji, rezulton se subjekti i rivlerësimit ka cenuar besimin e publikut te sistemi i drejtësisë dhe ndodhet në kushtet e pamundësisë për plotësimin e mangësive nëpërmjet programit të trajnimit.
5. Ky shkak shkarkimi, në bazë të një interpretimi sistematik, konstatohet se është renditur si shkak i fundit i shkarkimit në dispozitën që parashikon në ligjin nr. 84/2016 të gjitha rastet e shkarkimit të subjekteve të rivlerësimi, pikërisht neni 61 i tij. Kjo dispozitë ka në përbërje të saj çdo situatë shkeljesh ligjore të cilat, edhe nën frymën e neneve D, Dh dhe E të Aneksit të Kushtetutës, përfaqësojnë shkelje të ligjit të afta për të shkaktuar vendosjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra në raport me secilin prej kriterëve të rivlerësimit. Konkretisht, neni 61, pikat 1 dhe 3 janë shkaqe shkarkimi për kriterin e pasurisë, neni 61, pikat 2 dhe 3 janë shkaqe shkarkimi për kriterin e figurës, dhe neni 61, pika 4 është shkak shkarkimi për kriterin e aftësive profesionale. Në vlerësimin tim, në secilën situatë faktike që mund të lidhet me secilin prej kriterëve dhe që mund të klasifikohet në secilin prej rasteve të mësipërme, subjekti gjendet në kushtet e vendosjes së masës disiplinore të shkarkimit nga detyra. Në rast se shkeljet

e ligjit për secilin kriter, por edhe vetëm për njërin prej tyre janë tilla, që klasifikojnë situatën sipas asaj që parashikojnë pikat 1, 2, 3 e 4 të nenit 61, subjekti do të gjendet para vendosjes së masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, siç është edhe rasti objekt gjykimi, i cili me të drejtë është klasifikuar sipas parashikimit të nenit 61, pika 3 e ligjit.

6. Në vijim të këtij arsyetimi, mendoj se në çdo situatë faktike e ligjore për të cilën subjekti nuk klasifikohet në asnjërën prej rasteve të mësipërme të shkarkimit nga detyra, pasi shkeljet e konstatuara të ligjit nuk gëzojnë statusin e një shkeljeje që mund të shkaktojë klasifikimin e saj sipas asnjë prej rasteve të shkarkimit të cituara më lart, organet e rivlerësimit kanë të drejtë të bëjnë një vlerësim tërësor të tri kriterëve ose të procedurave të rivlerësimit, për të matur apo indikuar cenimin e besimit të publikut te drejtësia dhe për të konkluduar nëse ky fenomen ka ndodhur në rastin konkret dhe a është ai në një nivel që të prodhojë vendosjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.
7. Që ky vlerësim i organeve të rivlerësimit të konkludojë për vendosjen e një mase disiplinore, në këndvështrim të këtij arsyetimi, duhet të shtrihet mbi të tri kriteret e rivlerësimit dhe jo vetëm mbi njërin prej tyre.
8. Nëse organet e rivlerësimit do të aplikojnë zbatimin e nenit 61, pika 5 e ligjit nr. 84/2016 mbështetur vetëm në një kriter, ndërkohë që dispozita kërkon vlerësim në tërësi, në vlerësimin tim do të rrezikojnë një vlerësim me doza të larta subjektivizmi dhe përtej diskrecionit të organeve që vetë ligji ka lejuar.
9. Në vlerësimin tim, përtej faktit që në secilin rast që aplikohet një masë disiplinore për secilin nga shkaqet e parashikuara në pikat 1, 2, 3 e 4 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016, cenimi i besimit të publikut është i përfshirë nga vetë legjislatori në ngritjen e këtyre shkaqeve në nivelin e krijimit të pasojës që lidhet me masën disiplinore, që cenimi i besimit të publikut të qëndrojë si një shkak më vete shkarkimi dhe, në mungesë të shkaqeve të cilat në mënyrë autonome përbëjnë shkaqe për shkarkim, duhet që subjekti t'i nënshtrohet vlerësimit në të tria kriteret e rivlerësimit.
10. Në këto rrethana, në mbështetje të këtyre argumenteve, mendoj se nuk mund të aplikohet masa e shkarkimit e parashikuar nga neni 61 pika 5, e ligjit nr.84/2016 për një subjekt për të cilin procesi i rivlerësimit është kryer mbështetur vetëm në njërin prej kriterëve të procesit të rivlerësimit.
11. Për këto arsye, jam shprehur kundër konsiderimit si të drejtë të këtij qëndrimi të mbajtur nga Komisioni dhe Kolegji në çështjen objekt gjykimi, qëndrim i cili nuk ka afektuar votën time për lënien në fuqi të vendimit nr. 69, datë 10.10.2018, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për të gjitha shkaqe e tjera të konstatuara e të shpallura në vendim.

Gjyqtare

Ina RAMA

nënshkrimi